

**UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” GJILAN**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**DREJTIMI: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA NË ARSIMIN**

**FILLOR**



Roli i teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve të klasave 1-5

(Rast studimi - Rajoni i Anamoravës)

Mentore:

Prof. Dr. Asoc. Voglushe Kurteshi

Kandidate:

Nazlije Latifaj, MA

*Qershor, 2024*

## **DEKLARATË**

Unë Nazlije Latifaj me bindje të thellë deklaroj se ky punim i masterit me titullin “Roli i teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve të klasave 1-5” është punuar me origjinalitet dhe autonomi të plotë.

## **DEDIKIM**

*Këtë punim ia dedikoj bashkëshortit tim Fidanit dhe vajzës sime Helenës që me dashurinë e tyre më japin frymëzim dhe vullnet që mos të ndalem kurrë në rrugëtimin tim profesional e akademik.*

## **MIRËNJOHJE**

Për realizimin e kësaj teze të masterit, shpreh mirënjohje të thellë ndaj profesoreshës, njëherit mentores sime Prof.Voglushe Kurteshi, e cila më motivoi drejt realizimit të këtij studimi.

Falënderim të madh shprehi edhe ndaj nxënësve të ciklit fillor dhe mësimdhënësve klasor pa të cilët do të ishte e pamundur të realizohej i gjithë punimi. Si mësimdhënëse edhe vet, u jam mirënjohëse çdoherë.

Falënderim shumë të madh për përkrahjen që më dha familja – mbështetja ime me më e madhe.

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**MASHTI** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

**AF** Arsimi Fillor

**KKK** Korniza Kurrikulare e Kosovës

**KB** Kurrikula Bërthamë

**TIK** Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

**AI** Inteligjenca Artificiale

**VR** Realiteti Virtual

**RNK** Rezultatet e të Nxënit të Kompetencave

**RNL** Rezultatet e të Nxënit të Lëndës

**RNSH** Rezultatet e të Nxënit të Shkallës

**KD** Kompetenca Digjitale

## **ABSTRACT**

Today, technology is growing and becoming an integral part of our lives. With the rapid development of technology, the education system is becoming increasingly innovative thanks to the integration of advanced digital tools. These tools make the learning process more attractive and interactive by providing personalized learning experiences that adapt to the diverse needs and styles of students, ultimately improving learning outcomes.

To understand how technology affects the motivation of primary school students in the Anamorava region, we have conducted research and derived findings based on both theory and practice. This master's thesis aims to analyze the impact of technology on student motivation in primary education classrooms. The research methodology employed in this study is quantitative, providing results and information about the use of technology in the Anamorava region. Additionally, we incorporated data from existing literature to enhance our findings and enrich this paper.

The primary instrument used in this study was a questionnaire, completed by 30 elementary teachers and 100 students in a physical format. The results show that 29 out of 30 elementary teachers (96.7%) believe that the use of technology positively affects student motivation to learn. Similarly, 96 out of 100 students (88.9%) reported being highly motivated to learn when using technology in the classroom.

Moreover, the findings reveal the extent to which elementary teachers utilize technology in the classroom. Specifically, 30 out of 30 teachers (99.9%) reported using technological devices such as laptops, computers, televisions, and projectors to show students videos, illustrations, photographs, and presentations suitable for learning.

However, the research also identifies challenges faced by participants regarding the use of technology in the classroom. Based on these challenges, necessary recommendations are provided for future policymakers and researchers to guide further investigation.

**Key words:** technology, students and teachers, primary education, Anamorava region

## ABSTRAKTI

Ditëve të sotme teknologjia sa shkon e po rritet dhe po bëhet pjesë e rëndësishme e jetës tonë. Përmes zhvillimit të hovshëm të teknologjisë edhe sistemi i arsimit po bëhet gjithnjë e më inovativ e kjo falë integritit të teknologjisë së avansuar. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, procesi mësimor po bëhet më atraktiv dhe interaktiv. Këto pajisje digjitale po ngjallin motivim të nxënësit duke ju ofruar përvojë mësimore të personalizuar dhe përshtatje të nevojave dhe stileve të ndryshme të nxënësve drejt përmirësimit dhe arritjeve të rezultateve të të nxënësit. Për të parë se sa po ndikon teknologjia në nxitjen e nxënësve të ciklit fillor për të mësuar në rajonin e Anamoravës kemi konkluduar në disa gjetje dhe rezultate reale në teori dhe praktikë.

Prandaj, ky punim i masterit synon të analizojë ndikimin e teknologjisë në nxitjen e nxënësve për të mësuar në klasat e arsimit fillor. Metodologjia e hulumtimit e cila u përdor në këtë punim është metoda sasiore apo numerike nga e cila nxorrëm rezultate dhe informacione rreth përdorimit të teknologjisë në rajonin e Anamoravës. Gjithashtu, përfshijmë këtu edhe të dhënat e marra nga shtjellimi i literaturës që ndihmoi në reflektimin e gjetjeve dhe pasurimin e këtij punimi. Instrumenti i përdorur në punim është pyetësi me 30 mësimdhënës të klasor dhe pyetësi me 100 nxënës që u realizuan fizikisht në shkollë. Rezultatet tregojnë se 29 ose 96.7% mësimdhënës të klasor pohojnë në mënyrë të drejtë se përdorimi i teknologjisë ndikon në nxitjen apo motivimin e nxënësve për të mësuar. Ndërsa, 96 ose 88.9% e nxënësve kanë pohuar se ata motivohen shumë për të mësuar gjatë përdorimit të teknologjisë në klasë.

Poashtu, gjetjet na japin edhe rezultate ndaj asaj se si e përdorin mësimdhënës të klasor teknologjinë në klasë, atëherë themi se 30 apo 99.9% e mësimdhënësve pjesëmarrës e përdorin teknologjinë përmes pajisjeve teknologjike si: llaptopin, kompjuterin, televizorin, projektorin për të ju shfaqur nxënësve video, ilustrime, fotografi e prezantime të duhura për mësimnxënie.

Por, nga rezultatet e pjesëmarrësve në hulumtim gjejmë edhe sfidat që hasin për përdorimin e teknologjisë në klasë. Për këto sfida janë dhënë rekomandimet e nevojshme për politikbërësit dhe studiuesit e ardhshëm të cilët mund të orientohen për hulumtimet e mëtejshme.

**Fjalët kyçe:** teknologjia, nxënësit dhe mësimdhënësit, arsimit fillor, rajoni i Anamoravës

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Pyetësi për mësuesin klasor.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 2. Pyetësi për nxënësit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 3. Të dhëna demografike 1 .....	30
Tabela 4. Të dhëna demografike 2.....	30
Tabela 5. Të dhëna demografike 3.....	31
Tabela 6. Klasa që ju jepni mësim .....	31
Tabela 7. A keni ndjekur ndonjë trajnim në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë? ..	32
Tabela 8. Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha i pyetësit për mësuesin.....	32
Tabela 9. Tabela e korrelacionit 1.....	33
Tabela 10. Çfarë roli luan teknologjia në motivimin e nxënësve? .....	34
Tabela 11. Integrimi i teknologjisë në klasë sipas mësuesit.....	35
Tabela 12. Sfidat që ballafaqohen mësuesin gjatë përdorimit të teknologjisë në mësim. .....	36
Tabela 13. Testi Chi-Square .....	37
Tabela 14. A mund të ndani ndonjë ngjarje apo histori suksese ku teknologjia ka ndikuar në arritjen e nxënësve. ....	38
Tabela 15. Të dhëna demografike 4.....	39
Tabela 16. Të dhëna demografike 5.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 17. Klasa që i përkojnë nxënësit .....	39
Tabela 18. Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha i pyetësit për nxënësit. ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 19. Tabela e korrelacionit 2.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 20. Sa e përdor mësuesi/ja teknologjinë në klasë? .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>



## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Përdorimi i teknologjisë në klasë më motivon më shumë për të mësuar. ....	40
Figura 2. Teknologjia bën mësimin më argëtues për mua. ....	41
Figura 3. Duke përdorur teknologjinë kam më shumë kënaqësi të bashkëpunoj me shokët dhe shoqet në projekte dhe detyra. ....	42
Figura 4. Unë i kuptoj konceptet e panjohura më mirë kur përdoret teknologjia. ....	43
Figura 5. Teknologjia më ndihmon të kuptojë më lehtë temat e vështira. ....	44
Figura 6. Përdorimi i aplikacioneve dhe lojërave edukative më ndihmojnë të mësoj dhe kuptoj materialin mësimor. ....	45
Figura 7. Teknologjia më jep mundësi të mësoj për gjëra të reja që më interesojnë. ....	46
Figura 8. Mendoj se teknologjia më bën më të përgatitur për të ardhmen për të qenë një "eksplorues" në botën digjitale. ....	47
Figura 9. Përdorimi i teknologjisë mund të më shpërqendrojë gjatë mësimit. ....	48
Figura 10. Sa e përdor mësuesi/ja juaj teknologjinë në klasë? ....	49
Figura 11. A keni vënë re ndonjë ndryshim në notat ose performancën tuaj që nga zbatimi i teknologjisë në klasë?.....	50
Figura 12. Si e ndjehni veten kur përdoret teknologjia në mësim? ....	51

# LISTA E PËRMBAJTJES

DEKLARATË .....	2
DEDIKIM .....	3
MIRËNJOHJE .....	4
LISTA E SHKURTESAVE .....	5
ABSTRACT .....	6
ABSTRAKTI .....	7
LISTA E TABELAVE .....	8
LISTA E FIGURAVE .....	9
LISTA E PËRMBAJTJES .....	10
<b>KAPITULLI I PARË: QËLLIMI DHE HISTORIKU I HULUMTIMIT .....</b>	<b>12</b>
1.1 Hyrje .....	12
1.2 Vështrim historik i integritit të teknologjisë në arsim .....	14
1.3 Qëllimi i hulumtimit .....	15
1.4 Nevoja dhe arsyetimi i këtij studimi .....	15
1.5 Sqarimi i nocioneve themelore .....	15
<b>KAPITULLI I DYTË: SHQYRTIMI I LITERATURËS .....</b>	<b>17</b>
2.1 Ndikimi i teknologjisë në nxitjen e nxënësve për të mësuar .....	17
2.2 Teknologjia dhe qasja konstruktiviste .....	18
2.3 Roli i teknologjisë në arritjen e rezultateve efektive .....	20
2.4 Përfitimet dhe sfidat e teknologjisë në arsim .....	22
2.5 Studime relevante .....	25
<b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....</b>	<b>27</b>
3.1 Objektivat e hulumtimit .....	27
3.2 Pyetjet e hulumtimit .....	27
3.3 Hipotezat e hulumtimit .....	27
3.4 Mostra .....	28
3.5 Instrumenti .....	28
3.5.1 Pyetësori për mësimdhënësit klasor .....	28

3.5.2 Pyetësi për nxënësit .....	29
3.6 Përfundimi .....	Error! Bookmark not defined.
<b>ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET .....</b>	<b>30</b>
4.1 Analiza e të dhënave deskriptive - Pyetësi për mësimdhënësit klasor .....	30
4.2 Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha .....	32
4.3 Analiza e tabelës së korrelacionit .....	33
4.4 Analiza deskriptive e pyetjeve të hapura .....	34
4.5 Analiza dhe rezultatet statistikore të pyetësorit me nxënësit e klasave të arsimit fillor ....	39
<b>PËRFUNDIMI.....</b>	<b>52</b>
<b>REKOMANDIMET .....</b>	<b>54</b>
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>55</b>
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>59</b>
Shtojca A: Pyetësi për mësimdhënësit klasor .....	59
Shtojca B: Pyetësi për nxënësit .....	62

# KAPITULLI I PARË: QËLLIMI DHE HISTORIKU I HULUMTIMIT

## 1.1 Hyrje

Teknologjia është një fushë tejet e rëndësishme në fushën e arsimit e cila kohë pas kohe po zhvillohet dhe po integrohet në veprimtarinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Si fushë kryesore dhe aktuale në kohën tonë, teknologjia përmes pajisjeve dhe burimeve të saja po përmirëson dhe lehtëson të nxënit e nxënësve dhe mësimdhënësve. Langrova dhe Poulova (2013) theksojnë se objektivi kryesor i arsimit fillor është të formojë dhe zhvillojë kompetencat kyçe dhe në këtë mënyrë të sigurojë bazën e përgjithshme për nivelet e larta të arsimit. Fusha e teknologjisë u mundëson të gjithë nxënësve të arrijnë nivelin fillestar të edukimit informativ.

Në Kosovë në arsimin fillor, teknologjia fillon të mësohet prej klasës së parë e deri në klasën e pestë. Në klasën e parë teknologjia përdoret pothuajse në të gjitha lëndët për të lehtësuar të nxënit e nxënësve dhe kjo realizohet përmes stileve të të nxënit të tyre. Ndërkaq, teknologjia si fushë në vete në arsimin fillor mësohet duke u integruar në fushën kurrikulare Jeta dhe Puna përmes lëndës mësimore Shkathtësi për jetë. Kjo lëndë mësimore ka për qëllim të zhvillojë aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nxënësve për orientimin në jetën dhe punën e tyre. Duke qenë se kjo lëndë mësimore përfshin disa koncepte të përgjithshme vlen të potencojmë edhe kontributin e konceptit të Teknologjisë duke përfshirë TIK-un.

Vlen të theksojmë se kjo lëndë i mëson nxënësit të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe punë, me mjedisin dhe shëndetin, me materiale dhe përdorimin e tyre, trafikun dhe sjelljen në trafik, profesionet, përdorimin e mjeteve të thjeshta, kompjuterin, TV-në, mediat dhe planifikimin. Poashtu, kjo lëndë ndihmon në rritjen e njohurive dhe aftësive për jetën e përditshme. Një nga qëllimet kryesore të saj është zhvillimi i kompetencave digjitale të nxënësit përmes përdorimit të kompjuterit. Prandaj, misioni i shkollave është të mbështesin nxënësit në zhvillimin e aftësive digjitale. Gjithashtu, kurrikula, përmes çështjeve ndërkurrikulare dhe planit të programit tregon se nxënësve duhet t'u ofrohen kushte për përdorimin e mjeteve cilësore, materialeve mësimore dhe teksteve cilësore për të forcuar aftësitë gjuhësore dhe digjitale të tyre (Mexhuani, 2023).

Në konceptet e përgjithshme dhe përshkrimet e saja në Kurrikulën Bërthamë për nivelin fillor tek fusha kurrikulare Jeta dhe Puna shkruhet se “përdorimi i sigurt i TIK-ut për të

zhvilluar aktivitete praktike në realizimin e projekteve të ndryshme në formë elektronike, detyrave dhe hulumtime të ndryshme për nivelin e caktuar” (f.82).

Bytyqi-Beqiri (2023) në kërkimin e saj pedagogjik shkruan se:

Në Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës, kompetencat digjitale parashihen të realizohen përmes rezultateve të të nxënësve për kompetencat kryesore. Te kompetenca e të nxënësve Nxënës i suksesshëm, kompetencat digjitale reflektohen në rezultatin e dhënë “Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.” (MASHT, 2016, f.25), ndërsa te kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv për shkallën e dytë të kurrikulës kompetencat digjitale zbërthehen në rezultatin e tetë: “Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera” (MASHT, 2016, f.24) (f.71).

Mësimdhënësit klasor si lojtarë kryesor në nxitjen e përdorimit të teknologjisë në mësim, përmes përdorimit të pasjisjeve teknologjike ju ndihmon nxënësve të mësojnë dhe fitojnë njohuri dhe aftësi por edhe të zhvillojnë kompetenca digjitale për të adhmen. Me përdorimin e teknologjisë nxënësit e përfshirë kërkojnë informacione rreth saj për t’u zhvilluar dhe për t’u bërë eksplorues i së ardhmes. Kështu, ndihmohet dhe fitohet komunikimi, njohuritë dhe aftësitë teknike duke përfshirë edhe bashkëpunimin tek nxënësit. Teknologjia, pra në arsimin fillor cilësohet si një mjet i fuqishëm në formësimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe digjitalisht të aftë.

Sa i përket ndikimit të teknologjisë në motivimin e nxënësve thuhet se fëmijët janë të apasionuar pas teknologjisë sepse funksionon si një laps magjik për ta. Kur mësuesit u japin mundësinë të mësojnë përmes teknologjisë, motivimi i tyre rritet dhe kështu ata arrijnë të mbajnë mend mirë njohuritë (Critical Links, 2019).

## 1.2 Vështrim historik i integrimit të teknologjisë në arsim

Para shekullit 20-të, mjetet kryesore të mësimit ishin mësuesi, teksti dhe tabela e zezë. Librat, letrat, lapsat ishin mjetet themelore për komunikim dhe shkëmbim informacioni. Në shekullin e 20-të, teknologjia nisi të dominojë në arsim. Edhe sot, ndikimi i tij është i pamohueshëm. Roli i mësuesit ka ndryshuar, duke inkurajuar nxënësit të kërkojnë informacion vetë. Përdorimi i teknologjisë është ndryshim dramatik, duke kombinuar kompjuterë, video e tekste të ndryshme vetëm e vetëm të bëhet integrimi teknologjik në shkollë (Hajdari, 2019).

Teknologjia në arsim ka një histori që nis në vitet 1920, kur transmetimet radiofonike filluan të përdoren për mësimet në shkencat politike dhe histori. Në vitet 1950, Universiteti i Illinoisit zhvilloi sistemin e mësimit të bazuar në kompjuter PLATO. Gjatë viteve 1960, kasetat audio dhe video u përdoren për të shpërndarë leksione dhe përmbajtje edukative. Vitet 1970 dhe 1980 sollën kompjuterët personalë duke revolucionarizuar arsimin. Në vitet 1990, interneti u bë i aksesueshëm për publikun e gjerë dhe institucionet arsimore filluan të ofrojnë kurse dhe programe online. Sot, teknologjia është e domosdoshme në arsim. Ambientet virtuale të mësimit, kurset online dhe softuerët edukativë e kanë bërë mësimin të qasshëm për të gjithë me një lidhje interneti. Inovacionet si inteligjenca artificiale (AI) dhe realiteti i shtuar (VR) po transformojnë mënyrën e të nxënës, duke e bërë arsimin më personal, tërheqës dhe efektiv (Mdhlalose & Mlambo, 2023).

Shumica e përpjekjeve për të integruar teknologjinë në klasë synojnë të krijojnë praktika më cilësore, inovative dhe krijuese vetëm e vetëm të përparojnë në përdorimin e teknologjive të reja (ISTE, 2008; Woolfe, 2010). Kështu, integrimi i teknologjisë përkufizohet si zbatimi efektiv i teknologjisë edukative për të arritur rezultatet e synuara të të nxënës. Teknologjia edukative konsiderohet çdo mjet, pajisje ose aparaturë elektronike ose mekanike që mundet të përdoret për të ndihmuar nxënësit të arrijnë objektivat e të nxënës (Davies, Sprague, & New, 2008). Teknologjia edukative përfshin teknologjitë instruktive, të përdorura nga mësuesit për të dhënë mësim, dhe teknologjitë e të nxënës, të përdorura nga nxënësit për të arritur objektivat të caktuara të të nxënës (Davies & West, 2013).

### **1.3 Qëllimi i hulumtimit**

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojmë ndikimin dhe rolin e teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve të arsimit fillor, gjegjësisht të klasave 1-5.

### **1.4 Nevoja dhe arsytimi i këtij studimi**

Në shekullin e 21-të teknologjia ditë pas dite po bëhet pjesë e pandashme e jetës tonë. Shumë njerëz besojnë se ndryshimet më dramatike në arsim përfshijnë përdorimet e teknologjive të reja. Kjo paraqet një sfidë jashtëzakonisht të madhe në ditët e sotme, sidomos pas pandemisë kur nxënësit dhe mësuesit hasën vështirësi në përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe në zhvillimin e procesit mësimor.

Sot, njohja e kompjuterit është bërë domosdoshmëri andaj shumë mësuesit kanë nevojë për trajnim të vazhdueshëm në përdorimin dhe aftësimin e teknologjisë. Kështu, duke e parë të nevojshme digjitalizimin e arsimit fillor në Kosovë dhe ndikimin e tij te nxënësit u shtua ideja për të shqyrtuar interesimin e teknologjisë në nxitjen e nxënësve për të mësuar. Poashtu, nevoja për t'i përgatitur nxënësit që të bëhen liderë të shekullit 21 duhet t'i aftësojmë në komunikim, informacion, procesim, mendim kritik dhe në zgjidhjen e problemeve në shoqërinë teknologjike në mënyrë që të zhvillohet një shoqëri moderne me potenciale të mëdha dhe gjithëpërfshirëse.

Studimi do të hulumtojë dhe analizojë rolin e përdorimit të teknologjisë në klasa, efektin e tij në nxitjen e nxënësve për të mësuar dhe pikëpamjet e mësuesve ndaj përshtatjes me botën digjitale.

### **1.5 Sqarimi i nocioneve themelore**

**Teknologjia** është fushë e studimit e cila përfshin përdorimin e njohurive, aftësive dhe mjeteve për të krijuar, përpunuar informacionet në mënyra të ndryshme.

**Arsimi fillor** është niveli klasor që përfshin klasat nga 1 deri në 5. Gjatë këtij niveli nxënësit krijojnë bazën e të mësuarit themelor.

**Të nxënit** apo të mësuarit ka të bëjë me mësimnxënien si proces i absorbimit apo thithjes së njohurive dhe informatave që merr nxënësi nga mësimdhënësit.

**Nxënësi** është individ subjektiv që edukohet dhe arsimohet në një institucion arsimor duke zhvilluar aftësitë, njohuritë

**Kompetenca digjitale** është aftësia për të punuar, krijuar, mësuar dhe zgjidhur problemet në mënyrë inovative drejt efikasitetit dhe përmbushjes së nevojave personale dhe shoqërore.



# KAPITULLI I DYTË: SHQYRTIMI I LITERATURËS

## 2.1 Ndikimi i teknologjisë në nxitjen e nxënësve për të mësuar

Duke qenë se teknologjia sot zë një vend tejet të rëndësishëm kudo, atëherë edhe në fushën e arsimit është bërë pjesë kryesore e procesit mësimor. Teknologjia si fushë e studimit shtrihet thellë në proceset e veta por diskutimi dhe shtjellimi i literaturës dhe studimit tonë do ti vë theksin më shumë te përdorimi dhe roli i tij në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Qysh prej nivelit fillor, teknologjia bëhet pjesë e veprimtarisë mësimore përmes lëndëve dhe temave të ndryshme që shtjellohen dhe nxënësit bëhen pjesë e tyre.

Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie ka bërë që të jetë një sfidë e rëndësishme në kohët moderne. Ajo sjell një qasje të re ndaj dijes, leximit dhe librit duke ndikuar kështu në përmirësimin e procesit mësimor dhe marrëdhënies së mësuesit me nxënësin. Një nga qëllimet e arsimit parauniversitar në Kosovë është edhe mbështetja e nxënësve në zhvillimin e dijeve, shkathtësive, qëndrimeve e vlerave, në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike duke zhvilluar ndërmarrësinë dhe përdorimin e teknologjisë (MAShT, 2016).

Në klasa fillore, mësuesit mund të ndërtojnë strategji dinamike të mësimdhënies duke përdorur teknologjinë në mësim, kjo sepse gjërat bëhen më të lehta kur kombinohet teoria e edukimit dhe praktika me harduerin dhe softuerin kompjuterik (Wang, 2023).

Teknologjia në veprimtarinë mësimore përveç që fton nxënësit t'i qasen asaj, ata gjithashtu përdorin informacionin, realizojnë bashkëpunimin dhe zhvillojnë komunikimin efektiv dhe përmirësojnë aftësitë, shkathtësitë dhe vlerat e tyre. Kështu duke ndihmuar dhe kontribuar në përmbushjen e kompetencave të kurrikulare të Kosovës.

Përdorimi i softuerëve në mësimdhënie në gjuhën shqipe dhe letërsi lehtëson mësimin dhe studimin e gjuhës, përmirëson mjedisin dhe metodat e nxënies, krijon një mënyrë të re komunikimi midis nxënësve dhe mësuesve, promovon bashkëpunimin, përdor teknika të reja për të arritur efektivitet, dhe mundëson ndërtimin e një kurrikule që është e dobishme për nxënësit dhe zhvillon aftësitë e tyre krijuese, mendimin kritik, leximin dhe përdorimin e gjuhës.

Poashtu, në arsimin fillor nga njëra anë, është e nevojshme që mësuesit të mbështesin përdorimin e metodave dinamike të mësimdhënies me teknologjinë arsimore në lëndën e matematikës për t'iu treguar nxënësve transformimin e sipërfaqes së një paralelogrami dhe një drejtkëndëshi. Njëjtë vlen edhe në fushën e shkencave të natyrës, ku përmes teknologjisë mësohet cikli i ujit dhe strukturat e tokës në mënyra të ndryshme. Pasuar kështu edhe me mësimin e gjuhëve të huaja e veçanërisht të gjuhës angleze ku përmes gjenerimit të burimeve digjitale zhvillojnë informacionin dhe komunikimin mes vete. Kështu, nxënësit motivohen dhe kuptojnë lëndët, arrijnë rezultate më të mira dhe krijojnë një punë stimulimi dhe klimë bashkëpunimi (Wang, 2023).

Edukimi dhe arsimimi në TIK i ndihmon nxënësve që ata të zhvillohen dhe të vazhdojnë zhvillimet e tyre frytdhënëse dhe të avansuara. Qëllimi kryesor i arsimit është të pajisë nxënësit me aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet që u nevojiten për t'u bërë anëtarë produktivë të shoqërisë (Yilmaz, 2007; Amankwah, Oti-Agyen & Sam, 2017, siç është cituar në Tut et al., 2021).

Pajisja e shkollave me TIK shpesh është hapi i parë fillestar në agjendën e politikëbërësve, por investimi vetëm në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në shkolla nuk ka qenë gjithmonë i suksesshëm, siç është raportuar nga disa vende evropiane. Politikat duhet të përfshijnë një vizion afatgjatë, të shpjeguar në objektiva të qarta dhe të detajuara, të cilat përfshijnë: “zgjerimin e aksesit për të gjithë, përmirësimin e cilësisë së arsimit, riorganizimin dhe menaxhimin e proceseve arsimore, aftësimin për të nxënë gjatë gjithë jetës, rritjen e kompetencave të TIK-ut për nxënësit, mësuesit dhe stafin administrativ, dhe rritjen e efektivitetit në administrimin e shkollave” (Mexhuani, 2014).

## **2.2 Teknologjia dhe qasja konstruktiviste**

Teknologjia si pjesë e teorisë konstruktiviste të mësimdhënies është korniza e metodologjisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies e cila siguron aftësitë për të suportuar të gjitha format kryesore të kësaj teorie.

Kur teknologjia integrohet në klasë, mësuesit marrin qasjen konstruktiviste ndaj të mësuarit. Sipas statistikave, sasia e informacionit të disponueshëm dyfishohet çdo tri vjet. Deri në kohën kur fëmijët mbarojnë shkollën e mesme, nxënësit e sotëm do të jenë të ekspozuar ndaj më shumë informacioneve sesa gjyshërit e tyre gjatë gjithë jetës. Është pohuar se nëntëdhjetë

për qind e teknologjisë që do të përdorim në dekadën e ardhshme nuk është shpikur ose aktualisht nuk ka qasje në të për momentin (Wikipedia contributors, 2007).

Teoria konstruktiviste dëshmon se nxënësve u jepen mjete për të ndërtuar njohuritë e tyre. Mësimi konstruktivist dëshiron që mësuesit të pranojnë idenë se çdo nxënës do të konstruktojë, përfitojë dhe interpretojë njohuritë e tyre në mënyra të ndryshme. Konstruktivizmi është një proces aktiv dhe lejon nxënësit të kuptojnë botën e tyre (Adams, 2006).

Duke përdorur së bashku teknologjinë dhe qasjen konstruktiviste mësuesi siguron integrim dhe shfrytëzim më të mirë të mjeteve të teknologjisë në klasë në mënyra të përshtatshme dhe efektive, duke i dhënë mësimdhënies/nxënies mjetin e nevojshëm për të përmirësuar metodat e mëimit të cilat kanë në fokus të tyre nxënësin. Mësuesit përmes teknologjisë krijojnë aktivitete për nivele dhe stile të ndryshme të të nxënimit në mënyrë që ata të kuptojnë materialin sa më lehtë.

Stilet e të nxënimit janë: stili auditiv, stili vizuel dhe stili kinestetik.

Të besoj se përdorimi i vetëm i teknologjisë dhe kompjuterit do të sjellë përmirësim të rezultateve mësimore është si të neglizhosh rëndësinë e kapacitetit të mendjes njerëzore. Është e qartë se kompjuteri mund të jetë një mjet që ndihmon në lehtësimin e mësimdhënies dhe nxënies. Megjithatë, është po aq e qartë se ai nuk mund të zëvendësojë zgjedhjen e qasjes pedagogjike. Vendosja e qasjes së duhur pedagogjike gjatë orës së mëimit për të arritur rezultatet e dëshiruara të nxënies mbetet përgjegjësi e mësuesit (MAS, 2015).

Për t'u siguruar se mjetet e teknologjisë janë përdorur në mënyrë efektive mësuesi duhet t'i përdor ato nëpërmjet zbatimit të teorive të përshtatshme të mësimdhënies. Filozofia e kurrikulës së re të arsimit bazë është bazuar në qasjen konstruktiviste. Kjo qasje përkufizon: "të mësuarit ndodh kur personi ndërton së bashku mekanizmin për të mësuar dhe versionin e tij unik të dijeve, plotësuar këto me përvojat dhe aftësitë e tij personale" (Roblyer, 2006).

Sipas kësaj qasjeje dija ndërtohet, nuk transmetohet ndaj nxënësi gjeneron dije të reja nëpërmjet aktiviteteve, përvojave dhe eksperimenteve. Qasja konstruktiviste me fokus nxënësin në qendër, nxit përfshirjen e nxënësit në procesin e ndërtimit të dijeve dhe kërkon mënyra që mësuesi të jetë lehtësues në procesin mësimor dhe jo të diktojë informacionin. Kjo qasje dukshëm lidhet më mirë me integrimin e teknologjisë.

Për shembull mësimi zbulues si një formë e qasjes konstruktiviste inkurajon angazhimin aktiv, nxit motivimin, autonominë, përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e nxënësit. Nxënësi

udhëzohet nga mësuesi të bashkëveprojë dhe kryejë eksperimente për ta ndihmuar atë të ndërtojë dije dhe aftësi duke u nisur nga dijet dhe aftësitë paraprake.

Detyra e mësuesit është të bashkërendojë informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë thelbësor për të ndihmuar nxënësin të shoh se si konceptet zbatohen në situata reale. Kjo i jep mundësi nxënësit për të eksploruar mjedise më komplekse.

### **2.3 Roli i teknologjisë në arritjen e rezultateve efektive**

Përdorimi i teknologjisë është një mundësi e mirë e nxënësve dhe mësimitdhënësve për t'u angazhuar në përdorimin e formave të reja të të nxënësve dhe informacionit. Andaj edhe kompetencat e teknologjisë informative po japin rëndësi të madhe në kuptimin e njohurive të programeve kompjuterike dhe mësimin gjithëjetësor të mësimitdhënësve dhe nxënësve.

Zakonisht, roli i teknologjisë ndikon në të nxënësve për marrjen e rezultateve cilësore, ngase me përdorimin e tij ata janë më të përqendruar në mësim, kanë vëmendjen e plotë aty, ndjejnë kënaqësi, vlerësojnë dhe përshtaten me stilet e të nxënësve të tyre. Si për shembull, platformat adaptive të të nxënësve dhe aplikacionet edukative kujdesen për stilet dhe ritmet individuale të të mësuarit, duke u mundësuar nxënësve të përparojnë me ritmin e tyre. Kjo qasje e personalizuar ndihmon në adresimin e nevojave të nxënësve në një klasë të vetme, duke nxitur një mjedis mësimi më gjithëpërfshirës ku çdo nxënës mund të përparojë. Poashtu, teknologjia shtrihet edhe përtej mureve të klasës, udhëtimet virtuale në terren, lojërat edukative në internet dhe video të ndryshme sjellin përvoja të botës reale në kurrikulë, duke e bërë mësimin më të rëndësishëm dhe më të lidhur me jetën e nxënësve. Kjo ndërlidhje kultivon një ndjenjë kurioziteti dhe eksplorimi (Ascione, 2023).

Teknologjia ju ndihmon nxënësve në vizualizimin e përmbajtjeve të panjohura ose vizualizimin e koncepteve, në prezantimet multimediale që përdorin format e ndryshme të mediave, si imazhe, narracion dhe tekst. Poashtu, edhe format e tjera si simulimet dhe lojërat mund të shtojnë një nivel shtesë të ndërveprimit midis nxënësit dhe përmbajtjes duke kthyer procesin arsimor nga një proces pasiv në një proces aktiv (Courville, 2011). Gjithashtu edhe MAS (2015) thekson se detyra e mësuesit është të bashkërendojë informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me

programet kompjuterike i ndihmojnë nxënësve të zbatojnë koncepte të reja në jetë reale dhe eksplorimin e tyre në mjedise komplekse. Kështu, nxënësit njihen me kultura të ndryshme, me ngjarje aktuale, me historitë e rëndësishme të shtetit, udhëtimet virtuale, filma, klipe, prezantime që ndikojnë në aftësinë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemit.

Poashtu, Arifah (2014) theksoi se përdorimi i internetit rrit motivimin e nxënësve për të mësuar. Përdorimi i filmit në mësimdhënie i ndihmon nxënësit të kuptojnë temën me entuziazëm dhe të zhvillojnë njohuritë e tyre.

Përmes përdorimit të pajisjeve teknologjike shpjegohet më shumë njësia që zhvillohet në stile të ndryshme të të nxënësve duke ju përshtatur secilit nxënës dhe nevojave të tyre që të kontribuojnë në qëllimin e të nxënësve që kërkohet në mënyrë që ata të arrijnë rezultate të denja cilësore.

Nëse në klasa fillore posedohet:

*Interneti* – është teknologjia që mbështet dhe përmirëson procesin mësimor dhe administrimin e arsimit. Reci (2018) “Është teknologjia e cila ka revolucionizuar mësimdhënien në çdo skaj të botës. Me anën e tij, tashmë mësuesi nuk është e vetmja pikë e referimit, por është koordinatori i hyrjeve të reja në kulturën arsimore të nxënësve” (fq.7)

*Një kompjuter ose lloptop* - atëherë ju lejon nxënësve të përqendrohen në njësine që zhvillohet përmes pamjeve apo ekranit që duket dhe e kuptojnë përmbajtjen më shumë (por jo në mënyrë të zmadhuar). Kështu mund të ngjallet edhe diskutimi i drejtëpërdrejtë në klasë mes nxënësve dhe mes mësuesit rreth temës që zhvillohet. Përmes asaj teme që shtjellohet mësuesi/ja mund ta pasurojë atë ende nëpërmjet kyçjes në uebfaqe të ndryshme vetëm e vetëm për t’ua bërë nxënësve më interesante dhe më cilësore. Në këtë rast, posedimi i kompjuterit apo lloptopit në klasë ndihmon që nxënësit të njihen për së afërmi me mënyrën se si përdoret dhe pajisjet e tij.

*Disa kompjuterë ose lloptopë* – ju lejon nxënësve të punojnë në grupe në mënyrë që të bashkëpunojnë rreth tematikës që zhvillohet, në këtë mënyrë realizohet gjithëpërfshirja dhe interaktiviteti mes nxënësve. Këtu mund të realizohen kuize dhe lojëra të ndryshme edukative arsimore që nxënësit përfshihen dhe mësojnë duke garuar dhe duke luajtur. Gjithashtu nxënësit mund të realizojnë dhe zhvillojnë të mësuarit me bazë në projekte.

*Projektori* – është një teknologji apo pajisje teknologjike mjaft e përhapur në sistemin arsimor në Kosovë. Zakonisht me posedimin e projektorit në klasë lidhet kompjuteri apo lloptopi në

mënyra që ekрани dhe pamja që shfaqet të duket tërësisht nga e gjithë klasa (pra duke i bërë gjërat e vogla të mëdha). Mësuesi shfaq aktivitete, video në internet në lidhje me mësimet, gjithashtu mund të eksploroj manipulime virtuale të matematikës dhe lëndëve të ndryshme (Gilbertson, 2007). Shembull në një klasë të dytë të lëndës së matematikës ose shkencës, në projektor mund të tregohet një vizore duke e shpjeguar rëndësinë e fillimit të matjes nga zero, ose si të bëni matje në gjysmë inç ose milimetër (Moulton, 2006).

*Tabela e mençur* – posedimi i tabelës së mençur në klasë është një pasuri inovative ngase mësimet dhe qasjet në detyra apo aktivitete të ndryshme mund të realizohen edhe nga distanca. Çdo gjë që punon mësuesi në tabelë ju shfaqet edhe nxënësve pavarësisht se ku gjenden në distancë. Gjithashtu, këto tabela luajnë një rol vendimtar në bërjen e të mësuarit më ndërveprues dhe më tërheqës. Mësuesit mund të shfaqin përmbajtje multimediale si video, imazhe dhe animacione për të tërhequr vëmendjen e nxënësve dhe për t'i bërë mësimet më të paharrueshme. Kështu, një mësues mund të shfaqë një hartë të botës dhe më pas t'i bëjë nxënësit të përdorin veçoritë e saj ndërvepruese për të mësuar rreth vendeve dhe kulturave të ndryshme. Si rezultat, nxënësit zhvillojnë të menduarit kritik dhe bëhen më krijues dhe gjithashtu zhvillojnë dialogje dhe reagime të menjëhershme mes shokëve dhe shoqëve (Education A Step Ahead Trillium School, 2024).

*iPad* – edhe iPad duhet të lidhet me pajisjet e tjera teknologjike dhe internetin për të realizuar mësimet, detyrat e kërkuara ose për të bërë shënime digjitale. Zakonisht, ekрани i iPad i cili drejtohet me gisht mund t'i motivojë dhe angazhojë nxënësit, duke i mbajtur ata të interesuar për përmbajtjen më të gjatë dhe duke lejuar grupet të ndërveprojnë me pajisjen në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin objek (Clark & Luckin, 2013).

## **2.4 Përfitimet dhe sfidat e teknologjisë në arsim**

Shumë studime kanë treguar për të mirat dhe të metat e përdorimit të teknologjisë në klasë. Për t'i parë këto, ne qysh në fillim kemi vendosur pyetjet dhe objektivat hulumtuese të punimit dhe përmes shtjellimit të literaturës dhe analizës së gjetjeve në praktikë do të gjejmë përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe detyrave.

Teknologjia ka një ndikim pozitiv në mësimin e nxënësve, kjo sepse shpesh ju jep më shumë informacione për të mësuar. Nxënësit përmes teknologjisë kanë përfitime të shumta ngase ju ofron mundësi për të mësuar në mënyrë praktike që mund të integrohen në të gjitha fushat e kurrikulës shkollore, duke përfshirë matematikën, leximin, shkencën dhe studimet

shoqërore. Teknologjia gjithashtu ju jep nxënësve mundësi për të bashkëpunuar me shokët e tyre, duke rezultuar në të mësuarit e njëri tjetrit (Costley, 2014).

Përveq bashkëpunimit, përdorimi i teknologjisë ndihmon edhe në kursimin e kohës si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Mësuesit përmes përdorimit të teknologjisë shpenzojnë më pak kohë në punët administrative, si planifikimi mësimor, vlerësimet e detyrave, realizimi i aktiviteteve të ndryshme. Ndërsa, nxënësit mësojnë më lehtë kur shohin në mënyrë vizuale dhe kur dëgjojnë në mënyrë auditive nga mjetet teknologjike sesa në të mësuarit klasik e memorizimit të detyrave përmendësh.

Me përdorimin e mjeteve teknologjike në klasë shtohet kureshtja te nxënësit në atë se si po përdoret dhe pse po përdoret, kështu duke shtuar përqendrimin e tyre gjatë të nxënës. Si për shembull mund të marrim integrimin e iPad në mësimin e nxënësve që përfshin angazhimin, përmirësimin e shkrim-leximit digjital dhe rritjen e kohës për projekte të ndryshme frytdhënëse (Tahir & Arif, 2016). Ndërkaq, bazuar në hulumtimin e Nesterenko (2023) nxjerren disa avantazhe kryesore të përdorimit të teknologjisë në arsim ku nxënësit duhet t'i zotërojnë ato për ti përmbushur nevojat e shoqërisë moderne. Këto avantazhe janë vazhdimësia e procesit mësimor dhe integriteti i informacionit arsimor; lëvizshmëria dhe autonomia e nxënësit.

Gjithashtu, teknologjia ka rëndësi të madhe edhe për nxënësit me nevoja të veçanta, ku përfitimet nga TIK për ata janë:

- Kompjuterët e përmirësojnë qasjen e pavarur të nxënësve drejt arsimimit
- Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore mund të kryejnë detyra me tempo i cili atyre u përgjigjet
- Nxënësit me dëmtim të pamurit me ndihmën e internetit mund të qasen deri te informatat njëlloj si edhe nxënësit e tjerë
- Nxënësit me probleme më serioze dhe të shumëfishta në të mësuarit më lehtë mund të komunikojnë me ndihmën e TIK
- Nxënësit të cilët shfrytëzojnë vegla për komunikim me zë fitojnë vetëbesim dhe kredibilitet shoqëror në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë
- Vetëbesimi i rritur i TIK i motivon nxënësit që ta shfrytëzojnë internetin edhe në shtëpi, për nevojat e shkollës si dhe për kënaqësi (Aleksova & Dojcinovska, 2010, f.4)

Sfidat e përdorimit të teknologjisë në arsim i shfaqin prindërit e mësuesit shpeshherë sepse nuk ndjehen të sigurtë ndaj asaj se sa kohë duhet ta përdorin teknologjinë fëmijët, si dhe në çfarë forme ta përdorin. Sigurisht që këto hamendësime e brengosin gjithësecilin andaj edhe sipas studimit të Tahir dhe Arif (2016) efektet negative përfshijnë shpërqendrimin nga faqet e internetit dhe aplikacionet e shumta që janë të parëndësishme por që mund të fokusohen në to fëmijët. Gjithashtu në këtë studim theksohet si sfidë edhe mungesa e aplikacioneve mobile të përzgjedhura nga mësuesit dhe nevoja për kohë shtesë apo të mjaftueshme për përgatitjen dhe zhvillimin e trajnimeve.

Ndërkaq, si sfidat të tjera që shpalosen edhe në Kosovë por edhe në disa vende të tjera janë problemet me energjinë elektrike, mungesa dhe shpërndarja e internetit nëpër shkolla. Sipas një studimi si sfida kryesore fillimisht janë infrastruktura dhe lidhja e internetit, faktorët individualë dhe mbështetja administrative dhe materialet mbështetëse të kurrikulës dhe nxënësve. Pengesë tjetër e rëndësishme është edhe mungesa e aksesit në kompjuter, lidhjes në internet dhe teksteve shkollore të TIK (Kibirige, 2023).

Ndërkaq, sfidat shfaqen edhe te mësuesit në mënyrën e përdorimit të teknologjisë në klasë. Nëse në shkolla mësuesit nuk posedojnë kompjuterë adekuat dhe lidhje të shpejtë në internet, zbatimi i teknologjisë arsimore nuk është i realizueshëm. Gjithashtu, mësuesve nuk u sigurohet zhvillim profesional efektiv në teknologjitë e reja, ata nuk do të jenë në gjendje ta përdorin atë në potencialin e tij të plotë (Johnson et al, 2016).

Si sfida të tjera të kohëve të fundit rreth përdorimit të tepërt të teknologjisë tek nxënësit Ascione (2023) na jep edhe këto sfida aktuale:

**Izolimi social:** Përdorimi i tepërt i teknologjisë, veçanërisht në formën e mediave sociale, mund të kontribuojë në izolimin social. Njerëzit mund të kalojnë më shumë kohë duke ndërvepruar në internet sesa në mjediset sociale ballë për ballë.

**Shqetësimet e privatësisë:** Epoka digjitale ka ngritur çështje të rëndësishme të privatësisë. Mbledhja dhe shpërndarja e të dhënave personale, teknologjitë e mbikëqyrjes dhe potenciali për shkelje të të dhënave paraqesin rreziqe për privatësinë e individëve.

**Zhvendosja e punës:** Automatizimi dhe inteligjenca artificiale kanë çuar në shqetësime rreth zhvendosjes së punës. Disa punë tradicionale mund të zëvendësohen nga teknologjia, duke ndikuar në mundësitë e punësimit në industri të caktuara.



Çështjet shëndetësore: Koha e zgjatur para ekranit dhe qëndrimi ulur lidhur me përdorimin e teknologjisë mund të kontribuojnë në çështje shëndetësore si dobësimi i syve, çrregullime të gjumit dhe një mënyrë jetese sedentare, duke çuar në obezitet dhe probleme të ngjashme.

Kërcënimet e sigurisë kibernetike: Natyra e ndërlydhur e sistemeve digjitale i bën ata të ndjeshëm ndaj kërcënimeve kibernetike. Hakerimi, vjedhja e identitetit dhe krimet e tjera kibernetike paraqesin rreziqe të konsiderueshme për individët dhe organizatat.

## 2.5 Studime relevante

Rice (2024)

Rice në shkrimin dhe studimin e tij rreth angazhimit dhe motivimit të përdorimit të teknologjisë thotë se ndikon shumë në edukimin dhe qasjen e nxënësve ndaj mësimi. Së bashku me pajisje të ndryshme si telefonat inteligjentë, laptopët dhe tabletët dhe shërbimet e zhvillimit të softuerit të menaxhimit të shkollave luajnë rol vendimtar në thjeshtimin e detyrave administrative, përmirësimin e komunikimit dhe ofrimin e zgjidhjeve të fuqishme të menaxhimit të të dhënave për institucionet arsimore. Që nga shpërthimi i Covid-19 në vitin 2020, mësimi elektronik po zhvillohet ditë e më shumë dhe po ofron mundësinë për të mësuar në mënyra të ndryshme.

Wang (2023)

Në hulumtimin e saj shkroi se mësimdhënia tradicionale nuk ka zhvilluar metoda interaktive, zhvillim të mendimit kritik apo fokusim të përqendrimit të nxënësit në mësimdhënie. Ndërkaq, në mësimdhënien moderne dhe me përdorimin e teknologjisë në shkollën fillore ka konkluduar se teknologjia edukative luan një rol fasilites në veprimtarinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke krijuar një atmosferë pune me plotësimin e nevojave të mësuesit dhe nxënësve. Gjithashtu, nga eksperimenti që realizoi me 400 nxënës të shkollës fillore dhe 20 mësimdhënës, doli se përdorimi i teknologjisë edukative në mësimdhënie pasuron përmbajtjet mësimore, ndikon në reflektimin e mësuesit dhe reflektimin e elementeve të tjera përbërëse të procesit mësimor.

Muhammad and Schneider (2022)

Në hulumtimin e tyre rreth rolit të teknologjisë në arsim dhe motivimit të nxënësve për të mësuar potencuan se teknologjia në arsim është një forcë kryesore që rrit motivimin e nxënësve për të performuar më mirë. Faktorët që luajnë rol në këtë aspekt janë: miqësia ndaj përdoruesit, kënaqësia psikologjike dhe kurioziteti i përdoruesve për mjete të reja mësimore të cilat në mënyrë efikase ndikojnë në motivimin e nxënësve për të nxënë. Gjithashtu, punimi heton se si duhet të përdoret teknologjia për të rritur motivimin, kështu duke u përdorur mjete dhe teknologji të reja dhe inovative për ta bërë mësimin më të këndshëm dhe më interesant. Por në të njëjtën kohë rekomandohet që të zhvillohen më shumë mjete dhe aplikacione të bazuara në AI (inteligjencë artificiale) që do të luajnë role të rëndësishme në rritjen e motivimit të nxënësve. Si dhe të ndërmerren hapa adekuat për t'i bërë këto mjete më miqësore dhe ndërvepruese në mënyrë që kërkesat e nxënësve të ardhshëm të mund të plotësohen.

Francis (2017)

Në hulumtimin e tij rreth integritit të teknologjisë në arsim dhe ndikimin e tij në motivimin e nxënësve bëri një analizë dhe ndërhyrje në një grup prej 348 nxënës. Anketat e nxënësve u administruan për të vlerësuar perceptimin dhe motivimin e nxënësve, u rishikuar planet edukative të individualizuara të nxënësve dhe u bënë vëzhgime në klasë. Rezultatet kanë treguar se nxënësit ndjehen më të motivuar përmes përdorimit specifik të teknologjisë në klasë, qoftë për qëllime pedagogjike ose për akomodime.

# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kur jemi tek pjesa e metodologjisë atëherë dallojmë dy metoda të grumbullimit të të dhënave dhe analizimit të tyre: metodën kualitative dhe metodën kuantitative.

Metoda e përdorur në këtë hulumtim është metoda kuantitative (sasiore) që përfshin pyetëtorin me nxënësit e klasave të arsimit fillor dhe pyetëtorin me mësimdhënësit klasor.

## 3.1 Objektivat e hulumtimit

Ky hulumtim kërkon që t'i përmbush këto objektiva:

- Të hulumtojmë ndikimin e përdorimit të teknologjisë në të mësuarit e nxënësve të klasave fillor 1-5.
- Të analizojmë pikëpamjet e mësimdhënësve dhe nxënësve në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë.
- Të përpunohen dhe interpretohen rezultatet e fituara.
- Të arrihen rekomandime për rolin e teknologjisë në të mësuarit e nxënësve të klasave 1-5.

## 3.2 Pyetjet e hulumtimit

Duke u bazuar në qëllimin, objektivat dhe literaturën e shqyrtuar të studimit, atëherë ky studim kërkon që në mënyrë kritike të eksplorojë pyetjet hulumtuese si në vijim:

1. Cili është roli i teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve në arsimin fillor?
2. Si e përdor mësimdhënësi teknologjinë në procesin mësimor?
3. Cilat janë sfidat e përdorimit të teknologjisë në klasë?

## 3.3 Hipotezat e hulumtimit

Gjithashtu, ky hulumtim ka për qëllim të vërtetojë këto tri hipoteza të cilat janë:

1. Teknologjia ndikon në nxitjen e nxënësve për të mësuar më shumë.
2. Mësimdhënësit klasor pak e përdorin teknologjinë në procesin mësimor.
3. Mësimdhënësit klasor hasin vështirësi në përdorimin e teknologjisë në klasë.

### **3.4 Mostra**

Pjesëmarrës në këtë studim janë nxënësit dhe mësimdhënësit e arsimit fillor të shkollave publike, gjegjësisht të klasave 1-5 të rajonit të Anamoravës që përfshijnë tri komunat: Gjilan, Viti dhe Kamenicë.

Grumbullimi i të dhënave me nxënësit dhe mësimdhënësit klasor është realizuar fizikisht apo ballë për ballë. Gjithsej pjesëmarrës në realizimin e pyetësorit me nxënës janë 100 nxënës të klasave fillore 1-5, ndërsa në realizimin e pyetësorit me mësimdhënësit janë 30 mësimdhënësit klasor.

### **3.5 Instrumenti**

Instrumenti i përdorur në këtë hulumtim është: pyetësori. Pyetësori është realizuar fizikisht me mësimdhënësit klasor dhe nxënësit e arsimit fillor.

#### **3.5.1 Pyetësori për mësimdhënësit klasor**

Pyetësori për mësimdhënësit klasor përfshin 4 seksione me të dhëna të ndryshme të nevojshme për t'i kontribuar punimit. Pjesa e parë e pyetësorit përfshin të dhënat demografike, si: gjinia, mosha, komuna dhe klasën që japin mësim. Pjesa e dytë e pyetësorit përfshin zhvillimin profesional rreth trajnimeve që kanë mbajtur për teknologjinë dhe kontributin e tyre në mësimdhënie. Gjithashtu, mësimdhënësit shfaqen edhe idetë dhe nevojën e tyre për t'u trajnuar ende në fushën e TIK-ut.

Pjesa e tretë e pyetësorit përfshin njohjen e tyre me teknologjinë duke përfshirë pajisjet, platformat dhe programet teknologjike të nevojshme për t'i përdorur në klasë. Si dhe pjesa e fundit që përfshin 11 pohime në lidhje me pikëpamjet dhe përvojat e mësimdhënësve klasor rreth ndikimit të teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve në arsimin fillor. Kjo pjesë e pyetësorit është e ndërtuar prej disa pyetjeve të mbyllura që janë realizuar në bazë të shkallës së Likertit dhe prej pyetjeve të hapura të cilat do japin kontribut në gjetjet dhe rekomandimet e këtij hulumtimi.

Takimi u bë ballë për ballë me mësimdhënësit në secilën prej komunave të përfshira. Njëherit kam realizuar pyetësorët me 10 mësimdhënës klasor nga Komuna e Gjilanit, pastaj 10 mësimdhënës klasor të komunës së Kamenicës dhe në fund me 10 mësimdhënës klasor të Komunës së Vitisë. Mësimdhënësit klasor i takojnë klasave 1 deri 5 të arsimit fillor.

### **3.5.2 Pyetësi për nxënësit**

Pyetësi për nxënësit përfshinë pjesën demografike me pyetjet rreth klasës që janë aktualisht dhe komunës që i përkasin. Ndërsa, pjesa tjetër e pyetësit është e ndërtuar me 10 pohimet të cilat përfshijnë 5 përgjigjet të shkallës së Likertit dhe 2 pyetje të hapura që nxënësit kanë dhënë më gjerë mendimin e tyre. Nxënësit kanë dhënë mendimet/përgjigjet e tyre duke rumbullaksuar në ndonjërin prej 5 rezultateve të shkallës së Likertit. Realizimi i pyetësit me nxënës u bë fizikisht në shkollat e tri komunave në fokus. Përgjigjet e tyre janë marrë dhe do të analizohen në vijim.

Hulumtimi i përgjithshëm u realizua përmes përdorimit të pyetësit duke nxjerrë rezultate nga mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave fillore publike. Si të tillë 30 mësimdhënës klasor morën pjesë në studim duke dhënë pikëpamjet dhe përvojat e tyre rreth përdorimit dhe nxitjes së teknologjisë në të nxënësit të nxënësve. Pyetjet ishin të hapura dhe të mbyllura duke ofruar edhe një qasje cilësore, ngase mësimdhënësit shpalosen edhe idetë dhe nevojat e tyre rreth përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie. Më pas, në mënyrë fizike morën pjesë 100 nxënës të klasave 1-5 të arsimit fillor të shkollave publike. Gjithashtu edhe nxënësit dhanë përgjigjet nga perspektivat e tyre rreth përdorimit dhe motivimit të teknologjisë në mësim. Pyetjet ishin të krijuara në bazë të shkallës së Likertit duke ofruar qasje sasiore ndaj përgjigjeve. Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve me mësimdhënësit dhe nxënësit përfshin muajin Janar deri në Mars duke përfshirë edhe analizimin e përgjigjeve të tyre për këtë studim.

# ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Për analizën e të dhënave të këtij hulumtimi është përdorur programi statistikor SPSS i cili na ndihmoi në grumbullimin dhe analizat statistikore për gjetjet dhe rezultatet e nevojshme. Fillimisht është bërë analiza dhe diskutimi i pyetësorit për mësimitdhënësit klasor pastaj analiza dhe diskutimi i pyetësorit për nxënësit e nivelit fillor.

## 4.1 Analiza e të dhënave deskriptive - Pyetësori për mësimitdhënësit klasor

Analiza deskriptive e të dhënave demografike

### Në cilën komunë punoni?

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Gjilan	10	33.3
	Viti	10	33.3
	Kamenicë	10	33.3
	Total	30	100.0

Tabela 1. Të dhëna demografike 1

Nga tabela shohim se janë të përfshira tri komunat e rajonit të Anamoravës: Gjilani, Viti dhe Kamenica. Mësimitdhënës klasor nga komuna e Gjilanit janë 10 pjesëmarrës ose 33.3%, mësimitdhënës klasor nga komuna e Vitisë janë 10 pjesëmarrës ose 33.3% dhe mësimitdhënës klasor nga komuna e Kamenicës janë 10 pjesëmarrës ose 33.3%.

### Gjinia

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Femër	25	83.3
	Mashkull	5	16.7
	Total	30	100.0

Tabela 2. Të dhëna demografike 2

Gjithsej mësimitdhënës klasor janë 30 pjesëmarrës, prej tyre 25 ose 83.3% mësimitdhënëse klasore femra dhe 5 ose 16.7% mësimitdhënës klasor meshkuj. Nga këto të dhëna dallojmë se gjinia femërore dominon në arsimin fillor më shumë, pra, përgjigjet e marra në këtë hulumtim i kemi me një përqindje më të madhe nga mësueset klasore të gjinisë femërore.

### Mosha

		Frekuenca	Përqindja
Valid	22 - 32	19	63.3
	33 - 43	7	23.3
	44 - 54	4	13.3
	Total	30	100.0

*Tabela 3. Të dhëna demografike 3*

Në pyetjet demografike është përfshirë edhe grupet e moshave që janë të ndara në 4 grupe. Në grupin e parë përfshihet mosha 22-32 vjeç, ku kësaj grupmoshe i takojnë gjithsej 19 ose 63.3% mësimdhënës klasor. Grupmoshës së dytë 33-43 vjeç i takojnë 7 ose 23.3% mësimdhënës klasor, grupmoshës së tretë 44-54 vjeç i takojnë 4 ose 13.3% mësimdhënës klasor dhe të grupmoshës 55-65 vjeç nuk pati asnjë pjesëmarrës. Nga të dhënat e marra në takimet me mësimdhënësit klasor, shohim se më së shumti i takojnë grupmoshës më të re rreth 22 deri 32 vjeç.

### Klasa aktuale që jepni mësim

		Frekuenca	Përqindja
Valid	I	4	13.3
	II	9	30.0
	III	9	30.0
	IV	3	10.0
	V	5	16.7
	Total	30	100.0

*Tabela 4. Klasa që ju jepni mësim*

Mësimdhënësit klasor të cilët japin aktualisht mësim në klasën e parë janë 4 ose 13.3%, mësimdhënës klasor që japin mësim në klasën e dytë janë 9 ose 30%, mësimdhënës klasor që japin mësim në klasën e tretë janë 9 ose 30%, mësimdhënës klasor që japin mësim në klasën e katërt janë 3 ose 10% dhe mësimdhënës klasor që japin mësim në klasën e pestë janë 5 ose 16.7%. Nga këto të dhëna dallojmë se mësimdhënës pjesëmarrës në hulumtim janë më shumë të klasës së dytë dhe klasës së tretë.

### A keni ndjekur ndonjë trajnim në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë?

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Po	15	50.0
	Jo	15	50.0
	Total	30	100.0

*Tabela 5. A keni ndjekur ndonjë trajnim në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë?*

Në pyetjen e radhës se a kanë ndjekur mësuesit klasor ndonjë trajnim në lidhje me përdorimin e teknologjisë, nga analiza statistikore vërejmë se 15 ose 50% mësuesit klasor kanë ndjekur trajnim për teknologjinë dhe 15 ose 50% mësuesit klasor nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim të tillë. Nga këto të dhëna konstatohet se gjysma e pjesëmarrësve mësuesit klasor nuk janë trajnuar për rolin dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Mendoj se të gjithë mësuesit klasor duhet të angazhohen më shumë në zhvillimet e tyre profesionale duke marrë pjesë në trajnime që i kontribuojnë veprimtarisë arsimore e sidomos teknologjisë e cila është bërë pjesë e pandashme e jona. Ky rezultat sugjeron që ka një mundësi për të rritur pjesëmarrjen në trajnimet për përdorimin e teknologjisë, duke ndihmuar kështu gjysmën që nuk ka ndjekur ende trajnime.

Përpos pjesës demografike, mësuesit klasor ju nënshtruan edhe pjesës tjetër të pyetësorit që përfshihen pyetjet e krijuara me bazë të shkallës së Likertit dhe për këtë pjesë të pyetjeve ne kemi realizuar testin e besueshmërisë.

#### 4.2 Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha

Për të parë se sa i besueshëm është instrumenti i përdorur me pjesëmarrësit në hulumtim e përdorim Cronbach's Alpha i cili mat konsistencën e brendshme të grupit të variablave të përdorura në instrument.

Cronbach's Alpha	N of Items
.868	7

*Tabela 6. Testi i besueshmërisë Cronbach's Alpha i pyetësorit për mësuesit*

Në këtë rast, rezultati tregon se Cronbach's Alpha është 0.86 për një grup prej 7 elementesh të përfshira në instrumentin hulumtues. Vlera sa më e afërt me numrin 1 tregon një konsistencë



të lartë midis variablave të përfshira në instrument. Nga të dhënat, dallojmë se vlera e 0.86 është e lartë dhe tregon një nivel të lartë të konsistencës së variablave të përfshira. Këto na tregojnë se instrumenti është i besueshëm dhe mund të përdoret për të mbledhur të dhëna të besueshme për analizë dhe interpretim më të mirë të rezultateve.

### 4.3 Analiza e tabelës së korrelacionit

Për analizë të të dhënave të grumbulluara kemi përdorur analizën e korrelacionit dypalësh për të parë se sa janë të ndërlidhura dy variabla të rëndësishme për studim. Kjo na ndihmon për të kuptuar lidhjen lineare ndërmjet dy variablave të vazhdueshme. Për të parë këtë korrelacion, është bërë analiza e korrelacionit dypalësh e Pearsonit midis këtyre variablave “Përdorimi i teknologjisë lehtëson mësimin dhe kuptimin e përmbajtjes nga nxënësit” dhe variablës tjetër “Përdorimi i teknologjisë rrit nivelin e motivimit dhe angazhimit të nxënësve në mësim”.

		<b>Korrelacioni</b>	
		6. Përdorimi i teknologjisë rrit nivelin e motivimit dhe angazhimit të nxënësve në mësim.	2. Përdorimi i teknologjisë lehtëson mësimin dhe kuptimin e përmbajtjes nga nxënësit.
6. Përdorimi i teknologjisë rrit nivelin e motivimit dhe angazhimit të nxënësve në mësim.	Pearson Correlation	1	.701**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	30	30
2. Përdorimi i teknologjisë lehtëson mësimin dhe kuptimin e përmbajtjes nga nxënësit.	Pearson Correlation	.701**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	30	30

\*\* . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

*Tabela 7. Tabela e korrelacionit 1.*

Nga tabela shohim se kjo analizë tregon se ka një lidhje të rëndësishme dhe pozitive midis këtyre dy variablave. Vlera e korrelacionit të Pearson-it është 0.70, dhe kjo është shumë e rëndësishme në nivelin e 0.01 (niveli i rëndësisë statistikore). Kjo tregon se ka një lidhje të fortë midis përdorimit të teknologjisë dhe nivelit të motivimit dhe angazhimit të nxënësve në

mësim, si dhe midis përdorimit të teknologjisë dhe lehtësimit të mësimdhënies dhe kuptimit të përmbajtjes nga nxënësit.

Në esencë, këto rezultate sugjerojnë se përdorimi i teknologjisë ka një ndikim pozitiv në motivimin dhe angazhimin e nxënësve në mësim, si dhe në lehtësimin e mësimdhënies dhe kuptimin e përmbajtjes së mësim. Kjo sjell mbështetje për integrimin e teknologjisë në procesin mësimor dhe mësimdhënies në arsim.

#### 4.4 Analiza deskriptive e pyetjeve të hapura

Në pyetësin për mësimdhënës janë zhvilluar edhe katër pyetje me përgjigje të hapura në të cilat mësimdhënësit shpalosen më shumë për pikëpamjet e tyre në drejtim të përdorimit dhe zhvillimit të teknologjisë në mësim. Përgjigjet që morën sollën të dhëna cilësore duke i kontribuar këtij hulumtimi edhe më shumë. Përgjigjet janë koduar në programin SPSS dhe është bërë edhe analiza e tyre statistikore të cilat do t'i paraqesim si më poshtë:

#### Sipas juve, çfarë roli besoni se luan teknologjia në të nxënësit të nxënësve?

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Rol të rëndësishëm	11	36.7
	Rol pozitiv	18	60.0
	Rol neutral	1	3.3
	Total	30	100.0

Tabela 8. Çfarë roli luan teknologjia në motivimin e nxënësve?

Kjo tabelë nga tregon se numri total i pjesëmarrësve është 30 që e përbën 100% të mostrës. Në kategorinë e koduar “Rol të rëndësishëm” vërejmë frekuencën se 11 pjesëmarrës ose 36.7% besojnë se teknologjia luan një rol të rëndësishëm në të nxënësit të nxënësve. Në kategorinë “Rol pozitiv” vërejmë frekuencën se 18 pjesëmarrës ose 60% besojnë se teknologjia ka një rol pozitiv në të nxënësit të nxënësve. Kjo është edhe kategoria me frekuencën më të lartë, duke treguar se shumica e pjesëmarrësve kanë një qëndrim të favorshëm ndaj përdorimit të teknologjisë në arsim. Në kategorinë “Rol neutral” shohim se frekuenca është me 1 pjesëmarrës ose 3.3% që e konsideron rolin e teknologjisë si neutral në të nxënësit të nxënësve. Mendoj se kjo tregon një mungesë eksperience ose njohurie të mjaftueshme mbi ndikimin e teknologjisë në arsim.

**Si e integroni teknologjinë në klasë? Jepni ndonjë shembull nga përvoja juaj...**

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Integrimi në planin mësimor	13	43.3
	Përdorimi i videove, fotove, ilustrimeve	7	23.3
	Përdorimi i pajisjeve teknologjike si llaptop, projektor	4	13.3
	Përdorimi i aplikacioneve dhe faqeve të ndryshme	4	13.3
	Përdorimi për prezantime, kuize, demonstrime	2	6.7
	Total	30	100.0

*Tabela 9. Integrimi i teknologjisë në klasë sipas mësimdhënësve.*

Nga kjo tabelë dallojmë se total numri i pjesëmarrësve është 30 që e përbëjnë 100% të mostrës. Kategoritë e formuara në programin e SPSS nga përgjigjet e pjesëmarrësve në këtë pyetje të hapur janë: Integrimi në planin mësimor; Përdorimi i videove, fotove dhe ilustrimeve; Përdorimi i pajisjeve teknologjike, si: llaptopi dhe projektori; Përdorimi i aplikacioneve dhe faqeve të ndryshme të internetit; Përdorimi për prezantime, kuize dhe demonstrime të ndryshme.

Në kategorinë e parë “Integrimi në planin mësimor” kemi frekuencën prej 13 pjesëmarrësve ose 43.3% që e integrojnë teknologjinë përmes planit mësimor. Kjo përfshin planifikimin e përdorimit të teknologjisë në mësimet e tyre.

Në kategorinë e dytë “Përdorimi i videove, fotove dhe ilustrimeve” kemi frekuencën prej 7 pjesëmarrësve ose 23.3% që përdorin video, foto dhe ilustrime për të përforcuar më shumë mësimet apo njësitë mësimore që zhvillohen.

Në kategorinë e tretë “Përdorimi i pajisjeve teknologjike si llaptop, projektor” vërejmë se frekuenca është me 4 pjesëmarrës ose 13.3% që përdorin pajisje teknologjike, si llaptopë dhe projektorë për të shfaqur materialet mësimore.

Në kategorinë e katërt “Përdorimi i aplikacioneve dhe faqeve të ndryshme” dallojmë se frekuenca përbëhet me 4 pjesëmarrës ose 13.3% që përdorin aplikacione dhe faqe të ndryshme për të ndihmuar veprimtarinë e mësimdhënies dhe nxënies.

Në kategorinë e pestë “Përdorimi për prezantime, kuize dhe demonstrime” me frekuencë prej 2 pjesëmarrësve ose 6.7% që përdorin teknologjinë për prezantime, kuize dhe demonstrime gjatë orëve mësimore.

Nga këto të dhëna mund të përmbledhim se mësimitdhënësit klasor e integrojnë teknologjinë në mënyra të ndryshme por ka hapësirë për përmirësim. Si dominim i kësaj pyetje shohim padyshim se shumica e mësimitdhënësve me 43.3% e integrojnë teknologjinë drejtpërdrejt në përgatitjen e planit mësimor, duke treguar një qasje sistematike dhe të strukturuar për përdorimin e teknologjisë në arsim.

**Cilat janë sfidat që ballafaqoheni gjatë përdorimit të tekonologjisë në procesin mësimor?**

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Rrjeti/Interneti i dobët	8	26.7
	Mungesa e pajisjeve teknologjike	7	23.3
	Mungesa e internetit	5	16.7
	Nuk kemi sfida	5	16.7
	Mungesa e trajnimeve	5	16.7
	Total	30	100.0

*Tabela 10. Sfidat që ballafaqohen mësimitdhënësit gjatë përdorimit të tekonologjisë në mësim.*

Në pyetjen e radhës shohim se mësimitdhënësit hasin në sfida të përdorimit të tekonologjisë në mësim. Kategoritë e krijuara nga përgjigjet e marra nga mësimitdhënësit klasor janë: “Rrjeti/interneti i dobët”, “Mungesa e pajisjeve teknologjike”, “Mungesa e internetit”, “Nuk kemi sfida” dhe “Mungesa e trajnimeve”.

Në kategorinë e parë “Rrjeti/interneti i dobët” frekuenca është 8 pjesëmarrës ose 26.7% që identifikojnë problemet me rrjetin ose internetin e dobët si sfidën kryesore gjatë përdorimit të tekonologjisë në mësim.

Në kategorinë “Mungesa e pajisjeve teknologjike” frekuenca është 7 pjesëmarrës ose 23.3% që raportojnë mungesën e pajisjeve teknologjike të nevojshme, si llaptopë, projektorë dhe pajisje të tjera të nevojshme për të përdorur teknologjinë në klasë.

Në kategorinë “Mungesa e internetit” frekuenca është 5 pjesëmarrës ose 16.7% kanë përmendur mungesën e internetit si një sfidë. Kjo mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të qasur burime të rëndësishme digjitale për mësimitdhënie dhe mësim.

Në kategorinë “Nuk kemi sfida” frekuenca është 5 pjesëmarrës ose 16.7% nuk raportuan asnjë sfidë në përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.

Në kategorinë “Mungesa e trajnimeve” frekuenca është me 5 pjesëmarrës ose 16.7% që potencuan mungesën e trajnimeve në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.

Nga kjo analizë deskriptive e frekuencave shohim qartazi sfidat që paraqesin përgjigjet e mësimdhënësve klasor dhe që mund të themi se e vërtetojnë hipotezen e tretë të këtij studimi:

**“Mësimdhënësit klasor hasin vështirësi në përdorimin e tekonojgisë në klasë”.**

Gjithashtu për vërtetimin e kësaj hipoteze kemi përdorur edhe testin Chi-Square me një vlerë prej 13.333 që përfaqëson shkallën midis shpërndarjes së pritur dhe asaj të vëzhguar të të dhënave.

Cilat janë sfidat  
gjatë përdorimit  
të TIK në  
mësimdhënie?

Chi-Square	13.333 <sup>a</sup>
df	1
Asymp. Sig.	.000

a. 0 cells (0.0%) have expected frequencies less than 5. The minimum expected cell frequency is 15.0.

*Tabela 11. Testi Chi-Square*

Duke qenë se vlera e p është <0.001, kjo na jep arsye të qarta statistikore për të pranuar hipotezën se mësimdhënësit hasin vështirësi në përdorimin e teknologjisë në klasë. Pra, bazuar në rezultatet e testit Chi-Square, mund të themi me besim të plotë se mësimdhënësit klasor raportojnë sfida të konsiderueshme në përdorimin e teknologjisë gjatë procesit mësimor.

**A mund të ndani ndonjë ngjarje apo histori sukseesi ku teknologjia ka ndikuar në arritjen e nxënësve?**

		Frekuenca	Përqindja
Valid	Jo, nuk kam ndonjë histori sukseesi	2	6.7

Po, kam ngjarje të suksesit të arritur nga nxënësit	2	6.7
Realizimi i kuizeve/asociacioneve në gara për lëndët mësimore	7	23.3
Realizimi i prezantimeve të ndryshme edukative-arsimore	12	40.0
Zhvillimi dhe zgjidhja e problemeve në lojëra edukative	7	23.3
Total	30	100.0

*Tabela 12. A mund të ndani ndonjë ngjarje apo histori suksese ku teknologjia ka ndikuar në arritjen e nxënësve.*

Kjo tabelë na përshkruan në lidhje me ngjarjet ose historitë e suksesit ku teknologjia ka ndikuar në arritjen e nxënësve. Përgjigjet janë kategorizuar nga të dhënat e pjesëmarrësve (mësimdhënës klasor) për historitë apo ngjarjet e suksesit të ndikimit të teknologjisë në arritjet e nxënësve.

Kategoria e parë “Jo, nuk kam ndonjë histori suksesi” frekuenca tregon 2 pjesëmarrës ose 6.7% nuk kanë përmendur asnjë histori suksesi në lidhje me ndikimin e teknologjisë në arritjet e nxënësve.

Kategoria e dytë “Po, kam ngjarje të suksesit të arritur nga nxënësit” frekuenca tregon 2 pjesëmarrës ose 6.7% që kanë përmendur se kanë përvoja të suksesshme të arritura nga nxënësit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në mësim.

Kategoria e tretë “Realizimi i kuizeve/asociacioneve në gara për lëndët mësimore” me 7 pjesëmarrës 23.3% kanë përmendur suksesin e realizimit të kuizeve ose asociacioneve në gara për lëndët mësimore duke përdorur teknologjinë.

Kategoria e katërt “Realizimi i prezantimeve të ndryshme edukative-arsimore” frekuenca tregon 12 pjesëmarrës ose 40% kanë përmendur suksesin e realizimit të prezantimeve të ndryshme edukative-arsimore përmes përdorimit të teknologjisë.

Kategoria e pestë “Zhvillimi dhe zgjidhja e problemeve në lojëra edukative” frekuenca jep 7 pjesëmarrës ose 23.3% që kanë përmendur suksesin e zhvillimit dhe zgjidhjes së problemeve në lojëra edukative duke përdorur teknologjinë.

Kjo tabelë ofron një përmbledhje të historive të suksesit të ndikimit të teknologjisë në arritjet e nxënësve, duke theksuar rol pozitiv dhe potencialin e teknologjisë në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimin në shkolla.

#### 4.5 Analiza dhe rezultatet statistikore të pyetësorit me nxënësit e klasave të arsimit fillor

Fillimisht, analizat statistikore janë bërë duke filluar prej të dhënave demografike e pastaj edhe të pjesës tjetër statistikore të pyetësorit. Njëherit këto të dhëna paraqesin shpërndarjen e frekuencave për komunat Gjilan, Viti dhe Kamenicë.

		Komuna	
		Frekuenca	Përqindja
Valid	Gjilan	30	30
	Viti	29	29
	Kamenicë	41	41
	Total	100	100.0


Tabela 13. Të dhëna demografike 4

Gjithsej pjesëmarrës në hulumtim janë 100 nxënës të ciklit fillor. Nga tabela dallojmë se nxënës pjesëmarrës në hulumtim nga komuna e Gjilanit i kemi 30 ose 30% nxënës të klasave fillore, nga komuna e Vitisë janë 29 ose 29% nxënës pjesëmarrës dhe nga komuna e Kamenicës i kemi 41 ose 41% nxënës pjesëmarrës në hulumtim. Tabela tregon se pjesëmarrësit janë pothuajse me proporcion të njëjtë me komunat në fokus.

		Klasa	
		Frekuenca	Përqindja
Valid	I	9	9.0
	II	15	15.0
	III	15	15.0
	IV	31	31.0
	V	30	30.0
	Total	100	100.0

Tabela 14. Klasa që i përkojnë nxënësit.

Në të dhënat demografike kemi përfshirë edhe shpërndarjen e pjesëmarrësve sipas klasave të tyre. Sa i përket klasës së I-rë shohim se e përbëjnë 9 pjesëmarrës ose 9% të totalit. Klasën e II-të e përbëjnë 15 pjesëmarrës ose 15% të totalit. Klasën e III-të e përbëjnë 15 pjesëmarrës ose 15% të totalit. Klasën e IV-të e përbëjnë 31 pjesëmarrës ose 31% të totalit dhe klasën e V-të e përbëjnë 30 pjesëmarrës ose 30% të totalit.



1. Përdorimi i teknologjisë në klasë më motivon më shumë për të mësuar.


Figura 1. Përdorimi i teknologjisë në klasë më motivon më shumë për të mësuar.

Në pohimin e parë “Përdorimi i teknologjisë në klasë më motivon më shumë për të mësuar” dallojmë se 65 nxënës “pajtohen plotësisht” dhe 27 nxënës “pajtohen” me pohimin e dhënë. Ndërkaq, nxënës që janë përgjigjur “neutral” janë 4 nxënës, 2 nxënës kanë potencuar se “nuk pajtohen” dhe 2 nxënës kanë potencuar se “nuk pajtohen aspak”.

Nga këto të dhëna dallojmë se 92 nxënës nga 100 në total se pajtohen që motivohen më shumë për të mësuar me rastin e përdorimit të teknologjisë në klasë. Gjithashtu, përmes kësaj frekuence të të dhënave mund ta vërtetojmë hipotezën e parë.

**Hipoteza 1: Teknologjia ndikon në nxitjen e nxënësve për të mësuar më shumë.**






## 2. Teknologjia bën mësimin më argëtues për mua.

*Figura 2. Teknologjia bën mësimin më argëtues për mua.*

Në pohimin e dytë “Teknologjia bën mësimin më argëtues për mua” dallojmë se 51 nxënës janë përgjigjur “pajtohem plotësisht” dhe 41 nxënës janë përgjigjur “pajtohem”. Ndërsa, 6 nxënës janë përgjigjur “neutral”, 1 nxënës është përgjigjur “nuk pajtohem” dhe 1 nxënës është përgjigjur “nuk pajtohem aspak”.

Të dhënat tregojnë qartë një mbështetje të fortë për përdorimin e teknologjisë në mësim si një mjet për ta bërë mësimin më argëtues. Nga të dhënat vërejmë se pjesa më e madhe e nxënësve (92 nga 100 në total) kanë një mendim pozitiv rreth ndikimit të teknologjisë në argëtimin e mësimit.




**3. Duke përdorur teknologjinë kam më shumë kënaqësi të bashkëpunoj me shokët dhe shoqet në projekte dhe detyra.**

*Figura 3. Duke përdorur teknologjinë kam më shumë kënaqësi të bashkëpunoj me shokët dhe shoqet në projekte dhe detyra.*

Në pohimin e tretë “Duke përdorur teknologjinë kam më shumë kënaqësi të bashkëpunoj me shokët dhe shoqet në projekte dhe detyra” dallojmë se 43 nxënës “pajtohen plotësisht” dhe 43 nxënës “pajtohen” me pohimin e dhënë. Ndërkaq, nxënës që janë përgjigjur “neutral” janë 12 nxënës, 2 nxënës kanë potencuar se “nuk pajtohen”, kurse te “nuk pajtohem aspak” nuk kemi asnjë përgjigje të ndonjë nxënësi.

Nga këto të dhëna dallojmë qartazi se kemi një numër të barabartë mes kategorive “pajtohem plotësisht” dhe “pajtohem” me nga 43 nxënës që gjithsej bëjnë 86 nxënës. Pra, mund të themi se shumica e nxënësve kanë pohuar se me përdorimin e teknologjisë arrijnë të kënaqen më shumë me shokët dhe shoqet ngase bashkëpunojnë më mirë me njëri tjetrin në projekte dhe detyra.




#### 4. Unë i kuptoj konceptet e panjohura më mirë kur përdoret teknologjia.

Figura 4. Unë i kuptoj konceptet e panjohura më mirë kur përdoret teknologjia.

Në pohimin e katërt “Unë i kuptoj konceptet e panjohura më mirë kur përdoret teknologjia” mund të vërejmë nga rezultatet se 49 nxënës janë përgjigjur se “pajtohen plotësisht” dhe 40 nxënës janë përgjigjur me “pajtohem”. Ndërsa, në kategorinë “neutral” janë përgjigjur 6 nxënës, 3 nxënës kanë potencuar se “nuk pajtohen” dhe 2 nxënës janë përgjigjur se “nuk pajtohen aspak”.

Nga këto të dhëna mund të konkludohet se shumica e nxënësve (89 nxënës) pajtohen ose pajtohen plotësisht se ata i kuptojnë më mirë konceptet e panjohura kur përdoret teknologjia, duke sugjeruar se teknologjia është një mjet i vlefshëm për mësimin e tyre.

Vetëm një numër i vogël nxënësisht (5 nxënës) nuk pajtohen ose nuk pajtohen aspak me këtë pohim, ndërsa një numër i vogël (6 nxënës) kanë qëndruar neutral.




**5. Teknologjia më ndihmon të kuptojë më lehtë temat e vështira.**

*Figura 5. Teknologjia më ndihmon të kuptojë më lehtë temat e vështira.*

Në pohimin e pestë “Teknologjia më ndihmon të kuptojë më lehtë temat e vështira”, vërejmë se 49 nxënës janë përgjigjur se “pajtohen plotësisht” dhe 37 nxënës janë përgjigjur me “pajtohem”. Në kategorinë “neutral” janë përgjigjur 11 nxënës, në kategorinë “nuk pajtohem aspak” janë përgjigjur 2 nxënës dhe 1 nxënës është përgjigjur se “nuk pajtohet aspak” me këtë pohim.

Nga këto të dhëna mund të konkludohet se shumica e nxënësve (86 nxënës) pajtohen ose pajtohen plotësisht se teknologjia i ndihmon ata të kuptojnë më lehtë temat e vështira, duke sugjeruar se teknologjia është një mjet i vlefshëm për të përballuar materialin e vështirë mësimor. Vetëm një numër i vogël (3 nxënës) nuk pajtohen ose nuk pajtohen aspak me këtë pohim, ndërsa një numër më i vogël (11 nxënës) kanë qëndruar neutral.




**6. Përdorimi i aplikacioneve dhe lojërave edukative më ndihmojnë të mësoj dhe kuptoj materialin mësimor.**

*Figura 6. Përdorimi i aplikacioneve dhe lojërave edukative më ndihmojnë të mësoj dhe kuptoj materialin mësimor.*

Në pohimin e gjashtë “Përdorimi i aplikacioneve dhe lojërave edukative më ndihmojnë të mësoj dhe kuptoj materialin mësimor”, nga ky pohim vërejmë se 37 nxënës janë përgjigjur se “pajtohen plotësisht” dhe 49 nxënës janë përgjigjur se “pajtohen”. Ndërsa, në kategorinë “neutral” janë përgjigjur 8 nxënës, në kategorinë “nuk pajtohem” janë përgjigjur 4 nxënës dhe 2 nxënës janë përgjigjur se “nuk pajtohen aspak” me këtë pohim të dhënë.

Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se shumica e nxënësve (86 nxënës) pajtohen ose pajtohen plotësisht se përdorimi i aplikacioneve dhe lojërave edukative i ndihmon ata të mësojnë dhe kuptojnë materialin mësimor, duke sugjeruar se këto mjete teknologjike janë të vlefshme për procesin e tyre të mësimin. Vetëm një numër i vogël nxënësish (6 nxënës) nuk pajtohen ose nuk pajtohen aspak me këtë pohim, ndërsa një numër i vogël (8 nxënës) kanë qëndruar neutral.




**7. Teknologjia më jep mundësi të mësoj për gjëra të reja që më interesojnë.**

*Figura 7. Teknologjia më jep mundësi të mësoj për gjëra të reja që më interesojnë.*

Në pohimin e shtatë “Teknologjia më jep mundësi të mësoj për gjëra të reja që më interesojnë” dallojmë se 60 nxënës janë përgjigjur se “pajtohen plotësisht” dhe 37 nxënës janë përgjigjur se “pajtohen”. Ndërkaq, në kategorinë “neutral” janë përgjigjur 3 nxënës, kurse në kategoritë “nuk pajtohem” dhe “nuk pajtohem aspak” nuk ka ndonjë përgjigje të dhënë.

Nga këto të dhëna mund të themi se të gjithë nxënësit pajtohen ose pajtohen plotësisht që teknologjia ju jep mundësi të mësojnë gjëra të reja që ju interesojnë. Vetëm 3 nxënës kanë mbajtur qëndrim neutral ndaj këtij pohimi.




**8. Mendoj se teknologjia më bën më të përgatitur për të ardhmen për të qenë një "eksplorues" në botën digjitale.**

*Figura 8. Mendoj se teknologjia më bën më të përgatitur për të ardhmen për të qenë një "eksplorues" në botën digjitale.*

Në pohimin e shtatë “Mendoj se teknologjia më bën më të përgatitur për të ardhmen për të qenë një eksplorues në botën digjitale”, nga ky pohim vërejmë se kemi 63 nxënës që janë përgjigjur me “pajtohem plotësisht” dhe 31 nxënës janë përgjigjur me “pajtohem”. Ndërsa, në kategorinë “neutral” janë përgjigjur vetëm 3 nxënës, kurse në kategorinë “nuk pajtohem” janë përgjigjur 3 nxënës.

Nga këto të dhëna themi se 94 nxënës pajtohen ose pajtohen plotësisht se teknologjia i përgatit ata për të ardhmen për t’u bërë eksplorues në botën digjitale. Ndërsa 3 nxënës kanë qëndruar neutral dhe 3 nxënës janë përgjigjur se nuk pajtohen.




**9. Përdorimi i teknologjisë mund të më shpërqendrojë gjatë mësimit.**

*Figura 9. Përdorimi i teknologjisë mund të më shpërqendrojë gjatë mësimit.*

Në pohimin e nëntë “Përdorimi i teknologjisë mund të më shpërqendrojë gjatë mësimit”, dallojmë se 25 nxënës “nuk pajtohen aspak” dhe 45 janë përgjigjur me “nuk pajtohem”. Ndërkaq, në kategorinë “neutral” kemi 13 nxënës, në kategorinë “pajtohem” janë përgjigjur 14 nxënës dhe 3 nxënës janë përgjigjur me “pajtohem plotësisht”.

Nga këto dhëna dallojmë se 70 nxënës nuk pajtohen ose nuk pajtohen aspak se teknologjia mund t’i shpërqendrojë ata nga mësimi. Ndërsa 13 nxënës kanë qëndruar neutral ndaj këtij pohimi si dhe 17 nxënës janë pajtuar ose janë pajtuar plotësisht se teknologjia mund t’i shpërqendrojë ata gjatë mësimit.






*Figura 10. Sa e përdor mësuesi/ja juaj teknologjinë në klasë?*

Në pohimin e dhjetë “Sa e përdor mësuesi/ja juaj teknologjinë në klasë?”, dallojmë se 14 nxënës janë përgjigjur “aspak” e përdor mësuesi/ja teknologjinë në klasë, 26 nxënës janë përgjigjur “pak”. Ndërkaq, 16 nxënës kanë qëndruar “neutral” ndaj asaj se sa e përdor mësuesi/ja teknologjinë në klasë, kurse 30 nxënës janë përgjigjur “shumë” dhe 14 nxënës janë përgjigjur “jashtëzakonisht shumë” e përdorin mësuesit teknologjinë në klasë.

Të dhënat tregojnë se shumica e mësimitdhënësve e përdorin teknologjinë në një nivel të lartë “Shumë” dhe “Jashtëzakonisht shumë” me një total prej 44 mësimitdhënësish klasor. Megjithatë, 40 mësimitdhënës klasor pothuajse aq sa ata që e përdorin teknologjinë shumë janë në kategoritë “Aspak” dhe “Pak”. Kjo tregon një ndarje të përafërt mes atyre që e përdorin shumë teknologjinë dhe atyre që e përdorin pak ose aspak teknologjinë, duke sugjeruar se një pjesë e madhe e mësimitdhënësve ende e përdorin teknologjinë në një nivel të ulët.

Nga të dhënat e marra nga pjesëmarrësit, hipoteza mund të vërtetohet pjesërisht, kjo ngase një numër i konsiderueshëm mësimitdhënësish përdorin teknologjinë shumë dhe një numër po aq i madh e përdorin pak ose aspak teknologjinë. Kjo tregon një ndarje të qartë të përdorimit të teknologjisë në klasë nga ana e mësimitdhënësve.

***Hipoteza 2: Mësimitdhënësit klasor pak e përdorin teknologjinë në procesin mësimor.***




11. A keni vënë re ndonjë ndryshim në notat ose performancën tuaj që nga zbatimi i teknologjisë në klasë?

*Figura 11. A keni vënë re ndonjë ndryshim në notat ose performancën tuaj që nga zbatimi i teknologjisë në klasë?*

Në pohimin e njëmbëdhjetë “A keni vënë re ndonjë ndryshim në notat ose performancën tuaj që nga zbatimi i teknologjisë në klasë?” nga ky pohim kemi 78 nxënës që janë përgjigjur me “po” kam ndryshim në notat ose performancën time që nga zbatimi i teknologjisë në klasë. Në kategorinë “pak” janë përgjigjur vetëm 2 nxënës, ndërkaq në kategorinë “jo” janë përgjigjur 20 nxënës që theksojnë se nuk kanë pasur ndonjë ndryshim në notat ose performancën e tyre me rastin e përdorimit të teknologjisë në klasë.

Nga këto të dhëna rezultojmë se 76 nxënës kanë dhënë përgjigje se teknologjia tek ata ka sjellur impakt në të nxënit dhe performancën e tyre. Kjo shumicë e nxënësve na tregon se teknologjia ka sjellur një impakt pozitiv në arsimin fillor duke sjellur rezultate të mira për nxënësit e këtyre klasave. Ndërkaq, një numër i vogël i nxënësve kanë potencuar që nuk ka ndonjë ndryshim në notat ose performancën e tyre.



**12. Si e ndjehni veten kur përdoret teknologjia në mësim?**

*Figura 12. Si e ndjehni veten kur përdoret teknologjia në mësim?*

Në pohimin e dymbëdhjetë “Si e ndjehni veten kur përdoret teknologjia në mësim” dallojmë se 2 nxënës janë përgjigjur “jo mirë”, 4 nxënës janë përgjigjur “neutral”, 57 nxënës janë përgjigjur “mirë”, 27 nxënës janë përgjigjur me “shumë mirë” dhe 10 nxënës janë përgjigjur me “i/e kënaqur” me përdorimin e teknologjisë në mësim.

Në përgjithësi, nga këto të dhëna dallojmë se 94 nxënës nga 100 në total janë përgjigjur se ndjehen mirë dhe të kënaqur kur përdoret teknologjia në klasë. Ndërsa, 2 nxënës janë përgjigjur se nuk ndjehen mirë me përdorimin e teknologjisë në klasë, kurse 4 nxënës kanë qëndruar neutral ndaj kësaj pyetje.

## PËRFUNDIMI

Në kapitullin e fundit do të realizojmë përfundimin e këtij hulumtimi që me shtjellimin e literaturës dhe analizën e të dhënave të hulumtimit kemi gjetur përgjigjet e pyetjeve hulumtuese dhe vërtetimin e hipotezave. Këto gjetje na japin rezultate të rëndësishme për rolin e teknologjisë në nxitjen e nxënësve për të mësuar në klasat e ciklit fillor të rajonit të Anamoravës.

Pyetja e parë e hulumtimit: Cili është roli i teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve në arsimin fillor?

Për të ju përgjigjur pyetjes së parë hulumtuese konkludojmë që 29 mësuesit në klasor me 96.7% kanë pohuar se teknologjia ka rol të rëndësishëm dhe rol pozitiv në nxitjen dhe motivimin e nxënësve për të mësuar. Nga këto të dhëna rezultojmë që mësuesit në klasor të rajonit të Anamoravës janë të interesuar në përdorimin e teknologjisë kjo ngase i motivon nxënësit për të mësuar dhe ju lehtëson realizimin e mësimit në forma të ndryshme.

Ndërkaq, pyetja e dytë e hulumtimit është: Si e përdor mësuesi teknologjinë në procesin mësimor?

Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë në përgjigjet e mësuesve pjesëmarrës, ku 13 ose 43.3% mësuesit në klasor potencuan që teknologjinë e përdorin fillimisht duke e planifikuar përmes përgatitjeve mësimore, ndërsa 17 ose 56.6% mësuesit në klasor pohuan se e përdorin përmes përdorimit të pajisjeve teknologjike, si: lloptopi, kompjuteri, projektori, televizori etj. Përmes këtyre pajisjeve, mësuesit në klasor ju shfaqin video, fotografi, ilustrime dhe prezantime të ndryshme frytdhënëse për nxënësit. Gjithashtu, përmes përdorimit të uebfaqeve dhe aplikacioneve të ndryshme edukative, mësuesit në klasor realizojnë kuize, lojëra dhe demonstrime të ndryshme së bashku me nxënësit duke zhvilluar interaktivitet dhe zhvillim të menduarit kritik e krijues.

Ndërkaq, përgjigjet e nxënësve gjithashtu mbështesin përgjigjet e mësuesve në përdorimin e teknologjisë në klasë. Rreth 65% e mësuesve në klasor e përdorin teknologjinë në klasë duke treguar një prirje pozitive ndaj integritit të teknologjisë në veprimtarinë mësimore.

Pyetja e tretë e hulumtimit tonë është: Cilat janë sfidat e përdorimit të teknologjisë në klasë?

Nga kjo pyetje e hulumtimit, gjejmë në rezultatet e tona në teori se janë të njëjta me rezultatet e gjetura edhe në praktikë nga hulumtimi me mësimdhënësit rreth sfidave të përdorimit të teknologjisë në klasë. Mësimdhënësit klasor të rajonit të Anamoravës shpalosen këto sfida: rrjeti/interneti i dobët, mungesa e pajisjeve teknologjike, mungesa e internetit dhe mungesa e trajnimeve. Gjithsej 25 ose 83.4% mësimdhënës klasor pohojnë se kanë sfida në përdorimin e teknologjisë në klasë, duke filluar prej sfidave më bazike rreth shpërndarjes së internetit në klasë dhe internetin e dobët apo në mungesë të tij dhe mungesën e pajisjeve teknologjike pa të cilat pamundësohet realizimi i mësimi përmes teknologjisë.

Në këtë punim gjithashtu hulumtuesi ka realizuar edhe vërtetimin e hipotezave që ishin të vendosura qysh nga fillimi. Vërtetimi i këtyre hipotezave është bërë nga programi statistikor SPSS.

Hipotezat e vërtetuara janë:

Hipoteza e parë: Teknologjia ndikon në nxitjen e nxënësve për të mësuar më shumë.

Kjo hipotezë është vërtetuar nga analiza statistikore e frekuencave ndërmjet përgjigjeve të marra nga nxënësit pjesëmarrës në hulumtim. Pra, përgjigjet e nxënësve kanë vërtetuar se nxënësit ndjehen më të motivuar për të mësuar gjatë përdorimit të teknologjisë në klasë.

Hipoteza e dytë: Mësimdhënësit klasor pak e përdorin teknologjinë në procesin mësimor.

Për vërtetimin e kësaj hipoteze është përdorur analiza deskriptive e frekuencave të të dhënave të pjesëmarrësve në hulumtim. Nga nxënësit pjesëmarrës theksojmë se 40 nxënës potencuan që mësimdhënësit e tyre klasor e përdorin pak ose aspak teknologjinë në mësim, duke e vërtetuar pjesshëm këtë hipotezë nga e cila mund të nxjerrim edhe rekomandime për hulumtime të mëtejshme.

Hipoteza e tretë: Mësimdhënësit klasor hasin vështirësi në përdorimin e teknologjisë në klasë.

Vërtetimi i kësaj hipoteze është bërë nga analiza statistikore e frekuencave, ku mësimdhënësit kanë treguar për sfidat që hasin me rastin e përdorimit të teknologjisë në mësim. Nga 30 mësimdhënës, 25 mësimdhënës klasor ose 83.4% kanë raportuar se kanë sfida gjatë përdorimit të teknologjisë në klasë. Kjo hipotezë është vërtetuar edhe nga testi Chi-Square.

## **REKOMANDIMET**

Nga hulumtimi gjejmë se janë të nevojshme të jepen edhe disa rekomandime që do t'i kontribuonin rezultateve edhe më shumë drejt nevojës së përdorimit të teknologjisë në klasë dhe motivimit të nxënësve.

- Të rregullohet infrastruktura shkollore me energji elektrike dhe shpërndarje të fortë të rrjetit apo internetit.
- Të pajisjen me mjete dhe pajisje teknologjike secila klasë dhe shkollë fillore.
- Të sigurohet nevoja për mbështetje, trajnime dhe workshopeve të mëtejshme për mësuesin për përdorimin më të gjerë dhe më efektiv të teknologjisë në klasë.
- Të krijohen resurse edukative digjitale për pasurimin dhe zhvillimin e mësimin në mënyra të ndryshme.
- Të sigurohen materiale virtuale edukative dhe arsimore në gjuhë shqipe.

## REFERENCAT

Adams, P. (2006). Exploring Social Constructivism: Theories and Practicalities. *Education* 3-13, 34(3), 243-257. Retrieved from ERIC database.

Arifah, A. (2014). Study on the use of technology in ELT classroom: Teachers' perspective. Dhaka, Bangladesh: M.A. Thesis, Department of English and Humanities, BRAC University.

Ascione, L. (2023). The Impact of Technology on Education. Investing in teacher training and ensuring equitable access will empower the next generation with the skills they need. eSchool News - Education Innovations, Insights & Resources. Marrë nga: <https://www.eschoolnews.com/it-leadership/2023/12/11/the-impact-of-technology-on-education/#:~:text=Research%20about%20technology%20in%20education%20suggests%20an%20evolving%20impact%20on,enhance%20student%20engagement%20and%20motivation.>

Bytyqi-Beqiri, L.(2023). Adresimi i kompetencës digjitale në fushën kurrikulare Jeta dhe Puna. Kërkime pedagogjike. Përmbledhje punimesh 2. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë.

Courville, K. (2011). Educational Technology: Effective Leadership and Current Initiatives. Paper presented at the 2011 Louisiana Computer Using Educator's Conference, November 28th-29th, New Orleans, Louisiana.

Costley, C.K. (2014). Positive Effects of Technology on Teaching and Student Learning. October, 2014.

Cark, W. & Luckin, R. (2013). iPads in the Classroom. London Knowledge Lab. What the research says. Leading education and social research. Institute of Education University of London. Marrë nga: <https://cti.westminster.ac.uk/wp-content/uploads/sites/61/2017/02/2013-iPads-in-the-Classroom-Lit-Review-1-1.pdf>

Critical Links (2019). How can technology motivate students? Marrë nga:

<https://www.critical-links.com/wp-content/uploads/2020/07/How-can-technology-motivate-students.pdf>

Davies, R. S., & West, R. E. (2013). Technology integration in schools. In *Springer eBooks* (pp. 841–853). [https://doi.org/10.1007/978-1-4614-3185-5\\_68](https://doi.org/10.1007/978-1-4614-3185-5_68)

Wikipedia contributors. (2007, July 19). *Technology integration*. Wikipedia.

[https://en.wikipedia.org/w/index.php?title=Technology\\_Integration&oldid=145591780](https://en.wikipedia.org/w/index.php?title=Technology_Integration&oldid=145591780)

Education a Step Ahead Trillium School. (2024). Trillium Montessori School Markham.

Marrë nga: <https://www.trilliumschool.ca/smart-boards-to-become-a-staple-in-the-elementary-classrooms/>

Francis, J. (2017). The Effects of Technology on Student Motivation And Engagement In

Classroom-Based Learning. University of New England. DUNE: DigitalUNE. Marrë nga: <https://dune.une.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1120&context=theses>

Gilbertson, N. (2007). How to Integrate Technology. George Lucas Educational Foundation.

Edutopia. Marrë nga: <https://www.edutopia.org/technology-integration-guide-implementation>

Hajdari, B. (2019). TEMA: Interneti dhe teknologjia në mësimdhënie. *Journal of Advance Research in Business, Management and Accounting*, 5(12), 01–12. <https://doi.org/10.53555/nbma.v5i12.816>

Holt, K. (2015). The Impact of Technology on Primary Education. Capstone Projects and Master's Theses. 482. Retrieved from:

[https://digitalcommons.csumb.edu/caps\\_thes/482](https://digitalcommons.csumb.edu/caps_thes/482)

Johnson, A. M., Jacovina, M. E., Russell, D. E., & Soto, C. M. (2016). Challenges and

solutions when using technologies in the classroom. In S. A. Crossley & D. S. McNamara (Eds.) *Adaptive educational technologies for literacy instruction* (pp. 13-29). New York: Taylor & Francis. Published with acknowledgment of federal support.



- Kibirige, I. (2023). Primary teachers' challenges in implementing ICT in Science, Technology, Engineering, and Mathematics (STEM) in the Post-Pandemic Era in Uganda. *Education Sciences*, 13(4), 382. <https://doi.org/10.3390/educsci13040382>
- Langrova, P. & Poulova, P. (2013). The IT impact on primary education. Conference: Emerging eLearning Technologies and Applications (IECTA), 2013 IEEE 11<sup>th</sup> International Conference on. DOI:10.1109/IECTA.2013.6674453. Marrë nga: [https://www.researchgate.net/publication/261269542\\_The\\_IT\\_impact\\_on\\_primary\\_education](https://www.researchgate.net/publication/261269542_The_IT_impact_on_primary_education)
- Matthews, B., & Ross, L. (2010). *Research Methods: A practical Guide for the Social Sciences – 1st Edition*.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit. (2015). *Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Të nxënësit në situata, konstruktivizmi dhe teknologjia (Udhëzues për mësuesit)*.
- MAShT (2016). *Kurrikula Bërthamë për Arsimin Parauniversitar*. Prishtinë
- Musai, B. (1999). *Psikologji Edukimi, zhvillimi, të nxënësit, mësime*. Tiranë.
- Mdhlalose, D., & Mlambo, G. (2023). Integration of Technology in Education and its Impact on Learning and Teaching. *Asian Journal of Education and Social Studies*, 47(2), 54–63. <https://doi.org/10.9734/ajess/2023/v47i21021>
- Mexhuani, A. (2014). *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësime dhe nxënie*. Instituti pedagogjik i Kosovës. Prishtinë.
- Mexhuani, A. (2023). *Përfshirja e kompetencës digjitale në tekstet shkollore të lëndës Shkathësi për Jetë (klasat 1-5). Kompetenca digjitale e mësime dhe përfshirja në tekstet shkollore*. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë.
- Moulton, J. (2006). *The Power of the Big Screen: The Digital Projector Makes Instructional Materials Larger Than Life*. George Lucas Educational Foundation. Edutopia. Marrë nga: <https://www.edutopia.org/power-big-screen>

- Muhammad, N. M., & Schneider, M. (2022). The role of EdTech in enhancing learners' motivation. *ResearchGate*.  
[https://www.researchgate.net/publication/358007766\\_The\\_Role\\_of\\_EdTech\\_in\\_Enhancing\\_Learners'\\_Motivation](https://www.researchgate.net/publication/358007766_The_Role_of_EdTech_in_Enhancing_Learners'_Motivation)
- Nesterenko, I. (2023). Major benefits of using smart technologies in education. *Scientific Bulletin of Mukachevo State University. Series "Pedagogy and Psychology"*, 9(1), 31-38. doi: 10.52534/msu-pp1.2023.31.
- Reci, E. (2018). Teknologjia në mësimdhënie. Marrë nga:  
[https://elisareci.weebly.com/uploads/2/0/3/7/20379979/teknologjia\\_ne\\_mesimdhenie.pdf](https://elisareci.weebly.com/uploads/2/0/3/7/20379979/teknologjia_ne_mesimdhenie.pdf)
- Rice, D. (2024). The Impact of Technology on Student Motivation and Engagement. Voquent. Marrë nga: <https://www.voquent.com/blog/the-impact-of-technology-on-student-motivation-and-engagement/>
- Tahir, R., & Arif, F. (2016). Technology in Primary Schools: Teachers' perspective towards the use of mobile technology in children education. In *Studies in computational intelligence* (pp. 103–129). [https://doi.org/10.1007/978-3-319-33353-3\\_6](https://doi.org/10.1007/978-3-319-33353-3_6)
- Tut, E., Seren, N., Aydin-Çolak, E., & Kiroglu, K. (2021). Technology Education in Primary Schools: An Overview of Turkey and Scotland. *Psycho-Educational Research Reviews*, 10(3).
- Wang, M. (2023). Research on Using Educational Technology in Primary School Teaching and Learning. *Lecture Notes in Education Psychology and Public Media* 8 (1): 148-152. DOI: 10.54254/2753-7048/8/20230085 Marrë nga:  
[https://www.researchgate.net/publication/373922318\\_Research\\_on\\_Using\\_Educational\\_Technology\\_in\\_Primary\\_School\\_Teaching\\_and\\_Learning](https://www.researchgate.net/publication/373922318_Research_on_Using_Educational_Technology_in_Primary_School_Teaching_and_Learning)

## SHTOJCAT

### Shtojca A: Pyetësi për mësime të klasës

<b>Të dhënat demografike</b>	
Rajoni i Anamoravës Komuna:	a) Gjilan b) Viti c) Kamenicë
Gjinia	a) Femër b) Mashkull
Mosha	a) 22-32 b) 33-43 c) 44-54 d) 55-65
Klasa aktuale që jepni mësim	_____
<b>Zhvillimi profesional i mësimeve të klasës</b>	
A keni ndjekur ndonjë trajnim në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë?	a) Po b) Jo
Cilat trajnime ke ndjekur?	
<b>Njohja e mësimeve të klasës me teknologjinë</b>	
Cilat pajisje teknologjike i përdorni në klasë?	

Cilat programe kompjuterike aplikative i përdorni për realizimin e mësimdhënies?	
Cilat platforma digjitale i përdorni për zhvillimin e mësimin me nxënës?	
<b>Ndikimi i teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve në arsimin fillor</b>	
1. Përdorimi i teknologjisë në klasë tërheq vëmendjen e nxënësve gjatë mësimin.	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
2. Përdorimi i teknologjisë lehtëson mësimin dhe kuptimin e përmbajtjes nga nxënësit.	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
3. Teknologjia e bën mësimdhënien dhe mësimnxënien më atraktive dhe argëtuese.	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
4. Teknologjia ofron mundësi në shpjegimin e	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral

duhur të koncepteve komplekse.	d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
5. Përdorimi i teknologjisë rrit nivelin e motivimit dhe angazhimit të nxënësve në mësim.	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
6. Përdorimi i teknologjisë inkurajon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive midis nxënësve.	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
7. Përdorimi i teknologjisë ndihmon nxënësit në zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve.	a) Nuk pajtohem aspak b) Nuk pajtohem c) Neutral d) Pajtohem e) Pajtohem plotësisht
8. Sipas juve, çfarë roli besoni se luan teknologjia në të nxënit të nxënësve?	
9. Si e integroni teknologjinë në klasë? Jepni ndonjë shembull nga përvoja juaj?	
10. Cilat janë sfidat që ballafaqoheni gjatë	

përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor?	
11. A mund të ndani ndonjë ngjarje apo histori sukcesi ku teknologjia ka ndikuar në arritjet e nxënësve?	

### Shtojca B: Pyetësi për nxënësit

Të dashur nxënës,

Ju lutem gjeni pak kohë për të kontribuar në hulumtimin për "Rolin e teknologjisë në nxitjen e të mësuarit të nxënësve të klasave 1-5". Teknologjia është bërë pjesë e rëndësishme e jetës sonë dhe ndikon gjithnjë e më shumë në mënyrën sesi ne mësojmë dhe zhvillohemi. Ky hulumtim synon të zbulojë pikëpamjet tuaja në lidhje me atë se si teknologjia ndikon në përvojën tuaj mësimore në shkollën fillore. Ju lutem ti përgjigjeni pyetjeve me sinqeritet duke u bazuar në përvojat e juaja në klasë. Ju sigurojmë që përgjigjet e juaja do mbesin konfidenciale.

Në cilën komunë jetoni?	Gjilan      Viti      Kamenicë
Në cilën klasë jeni?	I      II      III      IV      V
1. Përdorimi i teknologjisë në klasë më motivon më shumë për të mësuar.	Nuk pajtohem aspak Nuk pajtohem Neutral

	<p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>2. Teknologjia bën mësimin më argëtues për mua.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>3. Duke përdorur teknologjinë kam më shumë kënaqësi të bashkëpunoj me shokët dhe shoqet në projekte dhe detyra.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>4. Unë i kuptoj konceptet e panjohura më mirë kur përdoret teknologjia.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>5. Teknologjia më ndihmon të kuptojë më lehtë temat e vështira.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>

<p>6. Përdorimi i aplikacioneve dhe lojërave edukative më ndihmojnë të mësoj dhe kuptoj materialin mësimor.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>7. Teknologjia më jep mundësi të mësoj për gjëra të reja që më interesojnë.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>8. Mendoj se teknologjia më bën më të përgatitur për të ardhmen për të qenë një “eksplorues” në botën digjitale.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>9. Përdorimi i teknologjisë mund të më shpërqendrojë gjatë mësimi.</p>	<p>Nuk pajtohem aspak</p> <p>Nuk pajtohem</p> <p>Neutral</p> <p>Pajtohem</p> <p>Pajtohem plotësisht</p>
<p>10. Sa e përdor mësuesi/ja juaj teknologjinë në klasë?</p>	<p>Aspak</p> <p>Pak</p>



	<p>Neutral</p> <p>Shumë</p> <p>Jashtëzakonisht shumë</p>
<p>11. A keni vënë re ndonjë ndryshim në notat ose performancën tuaj që nga zbatimi i teknologjisë në klasë?</p>	
<p>12. Si e ndjehni veten kur përdoret teknologjia në mësim?</p>	

**Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!**